**3. Ne Dokumenta Standarte te Tenderit me objekt " Rikonstruksion i rruges Dervish Gina " shtojca nr 10 , pika 2 kriteret e vecanta te kualifikimit , kapaciteti teknik pika 9 kerkohet : Makineritë e deklaruar ne shtojcen 9 nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera gjate periudhes se zbatimit te objektit. Per kete duhet te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqërisë ofertuese.**

*Nga Kontrolli i dokumentacionit te ngarkuar ne sistem rezulton si me poshte :*

*Mjeti Asfaltoshtruese Bitelli me nr shasie 990080 ,Mjeti asfaltoshtruese Bomag me nr shasie SN821837190002 , Autopompe betoni me targe AA187 HO ,Grejder me deklarate zhdoganimi te vitit 2008 Prerese asfalti me fature tatimore te vitit 2007 , Freze asfalti me fature tatimore te vitit 2007 jane paraqitur dhe ne tenderin me objekt “ Rikonstruksion i rruges Dervish Gina’ dhe ne tenderin me objekt ”Sistemim asfaltim i rruges se Krutjes nga Fier i Ri te Furri”*

*Si konkluzion deklarate e angazhimit te makinerive te shoqerise ”Shkelqimi 07”shpk nuk pranohet pasi mjetet e saj te siperpermendura do te jene te anagzuara ne zbatimin e objektit ” Sistemim asfaltim i rruges se Krutjes nga Fier i Ri te Furri” .*

*Kjo shoqeri me kapacitetin e saj teknik nuk verteton qe mund te kryeje punimet ne dy objekte te ndryshme njekohesisht*

*Bashkangjitur ketij procesverbali ndodhen :*

*Vleresimi perfundimtar i printuar nga sistemi i tenderit me objekt ” Sistemim asfaltim i rruges se Krutjes nga Fier i Ri te Furri” sot ne date 23.09.2016 ora 09.08.2016 ,*

*Shtojca nr 9”Mbi disponimin e makinerive ” e shoqerise ”Shkelqimi 07”shpk paraqitur ne tenderin me objekt ” Sistemim asfaltim i rruges se Krutjes nga Fier i Ri te Furri” qe u zhvillua ne date 01.08.2016*

*Shtojca nr 9 ” Mbi disponimin e makinerive” e shoqerise ”Shkelqimi 07”shpk paraqitur ne tenderin me objekt ” Rikonstruksion i rruges Dervish Gina ” qe u zhvillua ne date 08.08.2016*

*Deklarata mbi angazhimin e mjeteve te shoqerise e shoqerise ”Shkelqimi 07”shpk paraqitur ne tenderin me objekt ” Sistemim asfaltim i rruges se Krutjes nga Fier i Ri te Furri*

*Deklarata mbi angazhimin e mjeteve te shoqerise e shoqerise ”Shkelqimi 07”shpk paraqitur ne tenderin me objekt ”Rikonstruksion i rruges Dervish Gina ”*

*Deklarata mbi angazhimin e stafit teknik ” e shoqerise ”Shkelqimi 07”shpk paraqitur ne tenderin me objekt ” Sistemim asfaltim i rruges se Krutjes nga Fier i Ri te Furri”*

*Deklarata mbi anagzhimin e stafit teknik ” e shoqerise ”Shkelqimi 07”shpk paraqitur ne tenderin me objekt” Rikonstruksion i rruges Dervish Gina ”*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “**BOSHNJAKU.B** ” SHPK me adrese Lagjia ”Bishanake , Rruga Skenderbeu ,Nr.8,prane Karburantit ”Bolv Oil ” Zona Kadastrale nr. 8532, **FIER** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **18 468 580** ( tetembedhjete milion e katerqind e gjashtedhjete e tete mije e peseqind e tetedhjete ) **leke pa tvsh** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Bashkise Lushnje* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ( tridhjete diteve ) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej \_\_\_\_\_, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 23.08.2016

Ankesa: ka ose jo Nuk ka patur ankesa

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**BASHKIA BERAT**  
**FORMULAR I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Për:** Operatorin Ekonomik “NOVATECH STUDIO“ sh.p.k. me adrese perkatesisht :Tirane

**Procedura e prokurimit “ Kerkese per propozim ”** me mjete elektronike

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: (sasite , qellim kohezgjatja)**

*"Mbikqyrje punimesh ne objektin "Rikonstruksion I rruges 'Stadiumi i Vjeter –Stadiumi i Ri',rruga 'Stadiumi' rruga "Koli Vesho" dhe sheshit para stadiumit "*

Kohëzgjatja e kontrates, 150 dite nga dita e nenshkrimit e kontrates .

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike

[Data 15 .08 .2016] [Numri ].

Kriteret e perzgjedhjes se fituesit : cmimi me i ulet , X oferta ekonomikisht me e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “ A.SH ENGINEERING“ sh.p.k. me NIPT L31617003F me oferten 452 000 (katerqind e pesedhjetë e dymije) leke pa t.v.sh.
2. “ NOVATECH STUDIO“ sh.p.k. me NIPT L01717030C me oferten 727 188 ( shtateqind e njezet e shtate mije e njeqind e tetedhjetë e tete) leke pa t.v.sh.
3. “ HE & SK 11-11“ sh.p.k. me NIPT L19008502B me oferten 771 524 ( shtateqind e shtatedhjetë e nje mije e peseqind e njezet e kater ) leke pa t.v.sh.
4. “ VLER- INVEST& INFRATECH “ sh.p.k me NIPT K81721022P & K91628001D me oferten 1 200 000 ( njemilion e dyqind mije ) leke pa t.v.sh.
5. “ A&E ENGINEERING“ sh.p.k. me NIPT K72113010E me oferten 1 250 000 (njemilion e dyqind e pesedhjetë mije) leke pa t.v.sh.
6. “ REAN 95 “ sh.p.k. me NIPT J61827033V me oferten 1 258 000 (njemilion e dyqind e pesedhjetë e tete mije ) leke pa t.v.sh.
7. “ DERBI –E “ sh.p.k. me NIPT K77916947A me oferten 1 400 000 (njemilion e katerqind mije ) leke pa t.v.sh.
8. “ NORD –COMAT “ sh.p.k. me NIPT LO8501501Q me oferten 1 490 000 (njemilion e katerqind e netedhjetë mije ) leke pa t.v.sh.

9. “ GJEOKONSULT&CO “ sh.p.k. me NIPT K91810005U me oferten 1 780 000 (njemilon e shtateqind e tetedhjete mije ) leke pa t.v.sh.
10. “ ERSI/M “ sh.p.k. me NIPT J98624803O nuk ka oferte
11. “ CEC GROUP “ sh.p.k. me NIPT L11807013M me oferten 790 000 (shtateqind e nentedhjete mije ) leke pa t.v.sh.
- 12.“ ZENIT 06 “ sh.p.k. me NIPT K6173100D me oferten 1 255 000 (njemilon e dyqind e pesedhjete e pese mije ) leke pa t.v.sh.

Te skualifikuar :

KA

**1-**“ A.SH ENGINEERING“ sh.p.k. ka kete mangesi:

Licensa e pajisur nga Keshilli Kombetar i Restaurimeve eshte fotokopje ne kundershtrim me kriterin e kerkuar nga AK .

**2-**“ VLER- INVEST& INFRATECH “ sh.p.k ka keto mangesi:

Mungon inxhinieri me license te Restauratorit te pajisur nga Keshilli Kombetar i Restaurimeve i kerkuar si kriter nga AK .

**3-**“ DERBI-E “ sh.p.k ka keto mangesi:

Mungon inxhinieri me license te Restauratorit te pajisur nga Keshilli Kombetar i Restaurimeve i kerkuar si kriter nga AK .

**4-**“ NORD-COMAT “ sh.p.k ka keto mangesi:

Mungon Ekstrakti i regjistrit tregetar .

Mungon deklarata e gjendjes gjyqesore .

Mungojne pasqyrat financiare per vitin 2015.

Mungon inxhinieri me license te Restauratorit te pajisur nga Keshilli Kombetar i Restaurimeve i kerkuar si kriter nga AK .

**5-**“ ERSI/M “ sh.p.k ka keto mangesi:

Mungon formulari i ofertes .

Mungon deklarata e gjendjes gjyqesor .

Mungon inxhinieri me license te Restauratorit te pajisur nga Keshilli Kombetar i Restaurimeve i kerkuar si kriter nga AK .

Ne license mungon pika NP12 .

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik “ NOVATECH STUDIO“ sh.p.k., me adrese ne Tirane , se oferta e paraqitur,me një vlerë total 727 188 ( shtateqind e njezet e shtate mije e njeqind e tetedhjete e tete) leke pa tvsh eshte identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkise Berat, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30(tridhjete) ditëve nga dita e marrjes /publikimit te ketij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, procedura do të anulohet siç parashikohet ligjin nr. 9643 dt. 20.11.2006 "Për Prokurimet Publike" i ndryshuar

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 25.08.2016  
Ankesa: S.ka.

**BASHKIA SHIJAK**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Data: **02.09.2016**

Nga: **Bashkia Shijak.**  
Adresa: **Lagja Erzen, Shijak**

Per: **“A.L-ASFALT” sh.p.k**  
Adresa: **Xhafzotaj, pranë kryqëzimit 4 rrugët, Shijak**

Procedura e prokurimit: **Procedure e hapur**

Pershkrim i shkurtër i kontrates: **“Rikualifikim i sheshit tek lagja Lugina”**

Fondi limit: **21.002.162 (njëzetë e një milionë e dymijë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.**

Burimi i financimit: **Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.**

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **22.08.2016**

Publikime të mëparshme (nese zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data **01.08.2016**, Numri **30**]

Njoftojme se, kanë qene pjesemarrës në procedure këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1. Operatori ekonomik SHËNDELLI sh.p.k, NIPT: K07924803N**  
VLERA: **0 leke.**
- 2. Operatori ekonomik BOSH NJAKU. B sh.p.k, NIPT: K72627402H**  
VLERA: **17.503.036** (shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind e tremijë e tridhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH.**
- 3. Operatori ekonomik “A.L-ASFALT” sh.p.k, NIPT: K81511508A**  
VLERA: **20.911.140** (njëzetë milionë e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e dyzetë) **lekë pa TVSH.**



Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:

**1. SHËNDELLI sh.p.k, NIPT: K07924803N**

Perkatesisht per arsyet e meposhtme:

- a. Nuk ploteson kriteret e pergjithshme dhe te vecanta te kualifikimit
- b. Nuk ka paraqitur oferte ekonomike

**2. BOSHNJAKU. B sh.p.k , NIPT: K72627402H**

Perkatesisht per arsyet e meposhtme:

- a. Vertetimi qe tregon gjendjen financiare te shoqerise eshte i dates 05/08/2016 qe bie ne kundershtrim me kriterin e vecante te kualifikimit[2.1] kapaciteti ekonomik financiar pika 3 , ku thuhet qe ky vertetimduhet te jete i leshuar 5 dite perpara dites se hapjes te tenderit.
- b. Mungon licensa profesionale e shoqerise nga bashkia me kategorite “ punime me siperfaqe te gjelberta“ , “ dekore te mjediseve urbane” dhe “ndricim dhe sinjalizim urban”
- c. Operatori ekonomik nuk eshte paraqitur ne kantier me dt 15/08/2016 ora 10.00 per te cilen do te pajisej nga bashkia me vertetimin perkates .
- d. Mungojne mjetet autobitumatrice , autovince me ramp dhe autofshese pastruese per asfaltin, qe bie ne kundershtrim me kriteret e vecanta te kualifikimit , kapaciteti teknik.

Duke iu referuar procedures se lartpermendur, informojme “ **A.L-ASFALT” sh.p.k** me adrese : Xhafzotaj, pranë kryqëzimit 4 rrugët, Shijak se oferta e paraqitur, me nje vlere te pergjithshme prej **20.911.140** (njëzetëmilionë e nëntëqind e njëmbëdhjetëmijë e njëqind e dyzetë) **lekë pa TVSH** eshte identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur te paraqisni prane **Bashkise Shijak, Lagja Erzen, nr.tel +35557122152** kopjen e nenshkruar te formularit te kontrates dhe te sigurimit te kontrates, siç parashikohet ne dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) diteve nga dita e marrjes se ketij njoftimi.

Ne rast se nuk pajtoheni me kete kerkese, ose terhiqeni nga nenshkrimi i kontrates, do te konfiskohet sigurimi i ofertes suaj ( nese eshte kerkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit eshte bere ne daten 25.08.2016

Ankesa: **Jo**

**MINISTRIA E DREJTËSISË**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data 02.09.2016]

Nga: Ministria e Drejtësisë, Bulevardi “ Zogu i I“, Rr. “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë  
Për: Bashkimin e operatorëve ekonomik **Infosoft Office sh.p.k me NIPT J61820021C** me adrese:  
Rruga: Murat Toptani, dhe **Ikub info sh.p.k, me NIPT L11712002T** me adrese Rruga “Abdyl Frasheri”, Tiranë.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur”, (Prokurim me mjete elektronike).

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Aplikacioni Web për kartelat e të dënuarve dhe personelit”

Fondi limit: 88,670,000 (tetëdhjetë e tetëmilion e gjashtëqindë e shtadhjetë mije) lekë (pa TVSH).

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit : Afati kohor i dorëzimit dhe hapjes së ofertave në datën 19.08.2016, ora: 11:00

Publikime të mëparshme: Njoftimi i Kontratës botuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, të datës - 11.07.2016

*Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë ofertuesit e poshtëshënuar me vlerat përkatëse të ofruara :*

1. Bashkimi i operatorëve **InfoSoft Office sh.p.k me NIPT J61820021C** dhe **Ikub info sh.p.k, me NIPT L11712002T** me vlerë 86,374,890 (tetëdhjetë e gjashtëmilion e treqindë e shtatëdhjetë e katërmijë e tetëqindë e nëntëdhjetë) lekë pa t.v.sh.

2. Operatori ekonomikë **Synapse ATS sh.p.k** me NIPT L12321011H, me vlerë 87,625,000 (tetëdhjetë e gjashtëmilion e gjashtëqindë e njëzet e pesëmijë) lekë pa t.v.sh.

3. **Intracom Telecom Albania sh.p.k** me NIPT K12006001H i cili nuk ka paraqitur ofertë ekonomike , dokumentacion ligjor dhe teknik.

Janë skualifikuar operatorët e mëposhtëm:

**1.Synapse ATS sh.p.k** me NIPT L12321011H i cili nuk ka paraqitur, dokumentacion ligjor dhe teknik të kërkuar.

**2.Intracom Telecom Albania shpk** me NIPT K12006001H i cili nuk ka paraqitur ofertë ekonomike , dokumentacion ligjor dhe teknik.

\* \* \*

Referuar procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur”, informojmë se oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik **InfoSoft Office sh.p.k me NIPT J61820021C** me adrese: Rruga: Murat Toptani, dhe **Ikub info sh.p.k, me NIPT L11712002T** me adrese Rruga “Abdyl Frasheri”, Tiranë.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ministrisë së Drejtësisë, Bulevardi “ Zogu i I “, Rr. “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar), siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 25.08.2016

Ankesa: nuk ka patur.

**AUTORITETI PORTUAL DURRËS**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

Për: HAZIRI SH.P.K

Procedura e prokurimit: **Zbatim-Punime ne plotesim te kerkesave qe burojne nga plani i sigurise**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Zbatim-Punime ne plotesim te kerkesave qe burojne nga plani i sigurise**,afati i perfundimit te punimeve 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e lidhjes se kontrates.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*):Jo Buletini i Njoftimeve Publike :JO

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët x oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BE Elira shpk dhe AD-STAR sh.p.k NIPT J63423410S dhe NIPT J69102207W me vlere te ofertes 5.393.325 leke pa tvsh
2. Haziri sh.p.k NIPT J66702916G me vlere te ofertes 4.781.606 leke pa tvsh
3. Meni sh.p.k NIPT J61909018W me vlere te ofertes 5.709.011 leke pa tvsh
4. Varaku NIPT J61902509S sh.p.k nuk ka paraqitur Oferte.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Varaku shpk **NUK KUALIFIKOHET** nuk ka paraqitur oferte.Dokumentacioni I paraqitur ne tender nuk eshte I plote.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë HAZIRI sh.p.k me NIPT J66702916G,Adresa: Kukës Gjinaj Lagjia Hayiraj, Rruga Nacionale Kukës Gjinaj Km5, Yona Kadastrale Nr. 2282, , se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 4.781.606 leke pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë „Autoritetit Portual Durres,Lagjia nr 1 Rruga Tregtare,Durres sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 18.04.2016

Ankesa ka ose jo: JO

**UNIVERSITETI ALEKSANDER MOISIU DURRES**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

**Nga:** Universiteti Aleksander Moisiu Durres

**Për:** “Power Industries” sh.p.k,Njesia Bashkiake, Nr.5 Rruga Irfan Tomini, Pall GGP, KATI 1, Tirane  
**NUIS L51706022H,**  
**Procedura e prokurimit:** “Kërkesë për propozime”

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: MIRËMBAJTJE TË OBJEKTEVE NDËRTIMORE”  
PËR UNIVERSITETIN ”ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr., date .Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

çmimi më i ulët X

oferta ekonomikisht më e favorshme

**Fondi Limit: 6,226,795 lekë pa TVSH,** vene ne dispozicion nga te Ardhurat e Universitetit

**Data e zhvillimit të procedures së prokurimit:** 17.07.2016 ora 10:00

**Njoftojme se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë keta ofertues me vlerat perkatese të ofruara:**

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1 Operatori ekonomik “INA ” Shpk me NUIS J61814009W3,396,030 lekë pa TVSH:  
;
2. Operatori ekonomik “FLONJA” Shpk me NUIS J71826003M3,635,145 lekë pa TVSH:  
;
3. Operatori ekonomik “ANADA” Shpk me NUIS J41916003L3,670,840 lekë pa TVSH:  
;
4. Operatori ekonomik “DOKSANI-G” Shpk me NUIS L21809501H 3,851,955 lekë pa TVSH;
5. Operatori ekonomik “POWER INDUSTRIES” Shpk me NUIS L51706022H 5,336,863 lekë pa TVSH;;
6. Operatori ekonomik “BOSHNJAKU.B” Shpk me NUIS K72627402H me vlere 5,472,127 (pese milion e katerqind e shtatedhjte e dy mije e njeqind e njezet e shtate) lek pa t.vsh

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- 1-Operatori ekonomik “INA ” Shpk
  - 2-Operatori ekonomik “FLONJA” Shpk
  - 3-Operatori ekonomik “ANADA” Shpk
  - 4-Operatori ekonomik “DOKSANI-G” Shpk
  - 5-Operatori ekonomik “BOSHNJAKU.B” Shpk
- Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

**1.Operatori ekonomik “Ina” sh.p.k** në ofertën e paraqitur nuk e ka paraqitur Autorizimin e Prodhuesit sipas DST.

2- Sipas katalogut të paraqitur në ofertën tuaj konstatohet se për produktin bojë nuk plotësohen specifikimet teknike sipas DST të miratuara nga Autoriteti Kontraktor.

**2. Operatori ekonomik “FLONJA” Shpk** i është kërkuar të japë sqarime ku të justifikojë çmimin e ofruar, duke argumentuar dhe dokumentuar me prova shkresore mbi elementët e veçantë të ofertës, në përputhje me nenin 56 të LPP.

Operatori ekonomik me ka dhënë sqarime për justifikimin e çmimit të ofruar,

***KVO pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti “FLONJA” sh.p.k, me vendim nr.2, datë 08.08.2016 ka vendosur refuzimin e ofertës së paraqitur nga subjekti “FLONJA” sh.p.k, pasi nuk është në përputhje me Nenin 56 të LPP-së.***

**3. Operatori ekonomik “ANADA” Shpk**, 1-në ofertën e paraqitur nuk e ka plotësuar këtë kriter dhe nuk ka paraqitur Autorizim Prodhuesi të produkteve të ALUMINIT.

2- Sipas katalogut të paraqitur në ofertën e subjektit “ANADA” Shpk konstatohet se për produktin bojë nuk plotësohen specifikimet teknike sipas DST të miratuara nga Autoriteti Kontraktor.

3- Nuk ka paraqitur bilançin e vitit të fundit të çertifikuar nga organet tatimore dhe të audituar nga eksperti kontabël.

**4. Operatori ekonomik “DOKSANI-G” Shpk** ka mangesi pasi *Bilanci i paraqitur nga Operatori ekonomik nuk është i çertifikuar nga organet tatimore dhe nuk ka paraqitur raport auditimi nga eksperti kontabël.*

**5- Operatori ekonomik “BOSHNJAKU.B” Shpk** nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kërkesat të kërkuara në DST

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqerine “ **Për: “Power Industries”** sh.p.k,Njesia Bashkiake, Nr.5 Rruga Irfan Tomini, Pall GGP, KATI 1, Tirane

**NUIS L51706022H**, e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej:

*6.404.236 leke (gjashte milion e katerqind e kater mije e dyqind e tridhjetë e gjashtë)leke*, është ofertë e vlefshme dhe është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Universitetit Aleksander Moisiu Durrës, Lagj 1, Rruga Currilave, Durrës ,sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Ne zbatim te nenit 21, pika 3 paragrafi i pare, te VKM nr. 914 , date 29.12.2014, Autoriteti Kontraktor, njofton Operatorin Ekonomik te shpallur fitues. Po ne zbatim te bazes ligjore te siper cituar neni 21 paragrafi i dyte, Operatori Ekonomik, duhet ti pergjigjet kerkeses se Autoritetit Kontraktor Brenda 5(pese) diteve nga marrja e saj.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar,siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.



6. BOSHNIKU B sh.p.k. NIPT K72627402H  
Oferta ekonomike 5,724,909 (pesemilion e shtateqindenjetzet e kater mije e nenteqind e nente) leke pa TVSH

7. KTHELLA sh.p.k. NIPT J69303023D  
Oferta ekonomike 5,875,690 (pesemilion e teteqinde shtatedhjetepesemije e gjashteqind e nentedhjetete) leke pa TVSH

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:  
Nuk ka te skualifikuar

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik: “KOMBEAS” SH.A. me NIPT K88103301J, Adresa: Rruga Dod Lleshi, Lezhë, se oferta e paraqitur, për procedurën e prokurimit: “Rikonstruksioni i godinës së Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore Laç” me një vlerë të përgjithshme prej 4,313,043 (katërmilion e treqind e trembedhjetete mije e dyzet e tre) leke pa TVSH, është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Adresa: Rruga “Durrësit”, nr. 83, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 22.08.2016.  
Ankesa: Jo

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME NR.3 E PUNËTORËVE TË QYTETIT,**  
**TIRANE**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

Datë **02/09/2016**

**Nga:** Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, Tirane

**Për:** Operatorin ekonomik, **AL-TEK sh.p.k** me NIPT **K48130519Q**.

**Adresa:** Vaqarr, Rruga nacionale, Tiranë.

**Procedura e prokurimit:** Kërkesë për Propozime

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Procedurë “Kërkesë për Propozime” me objekt “**Blerje pellet dhe shperndarje ne objektet shkollore dhe parashkollore**”, kohëzgjatja e kontratës deri 31.12.2016 nga nënshkrimi i kontratës.

**Fondi limit: 2.450.000 (dy milion e katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH**

**Burimi i Financimit:** Buxheti i Bashkisë Tiranë

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit:** 15.08.2016

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara si më poshtë;

1. Operatori ekonomik **AL-TEK sh.p.k me NIPT K48130519Q**, me seli ne Adresa: Vaqarr, Rruga nacionale, Tiranë, me ofertë **2,431,000** (dy milion e katërqind tridhjetë e një mijë) Lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik **“BOLT” sh.p.k me NIPT K91517011V** me seli ne Adresa: Rr.Dritan Hoxha, Blloku Qintash, Laprakë, Tiranë me ofertë **2,386,120** (dy milion e treqind tetëdhjetëe gjashtë mijë e njëqind e njëzet) Lekë pa TVSH.
3. Operatori ekonomik **“ALCANP” Sh.p.k me NIPT J91505006Q**, me adrese Rruga “Frutikulturës”, Kamëz, Tirane, me ofertë **2,449,700** (dy milion e katërqind e dyzet e nëntë mijë e shtatëqind) Lekë pa TVSH.

**Skualifikohet:**

1. Operatori ekonomik **“BOLT” sh.p.k me NIPT K91517011V** për shkak se nuk plotëson kriteret e veçanta sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit (DST) të cilat janë si më poshtë;
  - a) Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur autorizimin e prodhuesit të mallit objekt prokurimi, kriter i vendosur nga Autoriteti Kontraktor.
  - b) Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur raportet e testimi të mallit objekt prokurimi të kërkuara në DST-ë nga Autoriteti Kontraktor.
  - c) Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur deklaratën ku merr përsipër shpërndarjen e pelletit me punonjësit dhe me automjetet e tij në objektet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.
  - d) Parregullsi në dokumentacionin e paraqitur për automjetet. Nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar disponimi në pronësi ose me qira i të paktën dy mjeteve të transportit me kapacitet mbi 1 ton të cilat do të përdoren për shpërndarjen e pelletit në objekte, për të cilat kërkohet leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit. Operatori Ekonomik “Bolt” sh.p.k ka mangësira në këtë kriter të vendosur nga Autoriteti Kontraktor. Për mjetin me targë AA 874 KA operatori ekonomik ka paraqitur vetëm çertifikatën e kontrollit teknik. Ndërsa për mjetin e dytë me targë AA 627HD operatori ekonomik ka paraqitur çertifikatën e pronësisë të vlefshme, siguracionin e mjetit i cili ka skaduar me datë 04.08.2016 kur afati për dorëzimin e ofertave ka qënë me datë 15.08.2016. Duhet të paraqitet siguracioni i vitit pasardhës. Operatori ekonomik ka paraqitur gjithashtu çertifikatën e kontrollit teknik e cila është e vlefshme deri më datë 05.08.2016 kur afati për dorëzimin e ofertave ka qënë me datë 15.08.2016 dhe duhet të paraqitet çertifikata e kontrollit teknik e vitit pasardhës.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, Operatorin ekonomik; **AL-TEK sh.p.k me NIPT K48130519Q**, me seli ne Adresa: Vaqarr Rruga nacionale, Tiranë, se oferta me vlerë **2,431,000** (dy milion e katërqind tridhjetë e një mijë) **Lekë pa TVSH**, e paraqitur për tenderin me objekt **“Blerje pellet dhe shperndarje ne objektet shkollore dhe parashkollore”**, me afat të



kryerjes së shërbimeve deri 31.12.2016 nga nënshkrimi i kontratës, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit, Tiranë, Rruga 5 maji, pranë Tregut të Medresesë**, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe fitues do të shpallet operatori ekonomik i renditur i dyti "ALCANI" Sh.p.k, NIPT J91505006Q me ofertë 2,449,700 (dy milion e katërqind e dyzet e nëntë mijë e shtatëqind) Lekë pa TVSH, sipas të ligjit Nr.9643 date 20.11.2006 "Për prokurimet publike".

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 25/08/2016**

**Ankesa: S`ka pasur**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME NR.3 E PUNËTORËVE TË QYTETIT,**  
**TIRANE**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

Datë **02/09/2016**

**Nga:** Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, Tirane

**Për:** Operatorin ekonomik, "ALCANI" Sh.p.k me NIPT J91505006Q.

**Adresa:** Rruga "Frutikulturës", Kamëz, Tirane

**Procedura e prokurimit:** Kërkesë për Propozime

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Procedurë "Kërkesë për Propozime" me objekt "Blerje Dru Zjarri dhe shperndarje ne objektet shkollore dhe parashkollore", kohëzgjatja e kontratës deri 31.12.2016 nga nënshkrimi i kontratës.

**Fondi limit:** 6,013,333 (gjashtë milion e trembëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e tre) Lekë pa t.v.sh

**Burimi i Financimit:** Buxheti i Bashkisë Tiranë

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit:** 15.08.2016

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara si më poshtë;

1. Operatori ekonomik "ALCANI" Sh.p.k me NIPT J91505006Q, me adrese Rruga "Frutikulturës", Kamëz, Tirane, me ofertë 6,013,060 (gjashtë milion e trembëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik "Gjergj Buça" Sh.p.k me NIPT K31331547R, me adrese Rruga "Autostrada Tiranë -Durrës", Ura e Dajlanit, Lagja 14, Durrës, me ofertë 5,822,000 (pesë milion e tetëqind e njëzet e dy mijë) Lekë pa TVSH.

**Skualifikohet:**

1. Operatori ekonomik **“Gjergj Buça” Sh.p.k me NIPT K31331547R** për shkak se nuk plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit (DST) të cilat janë si më poshtë:
  - a) Vërtetimi i OSHEE nuk është lëshuar në datën e përcaktuar në DST sipas kërkesave ligjore. Duhet të konfirmonte shlyerjen e detyrimeve të maturuara që do të thotë duhet të lëshohej pesë ditë para depozitimit të ofertës.
  - b) Leja mjedisore e tipit C është për Nikolin Gjaci dhe jo për operatorin ekonomik Gjergj Buça.
  - c) Operatori ekonomik nuk e përcakton në cilin vend ndodhet magazina ku është i depozituar malli objekt prokurimi. Në DST-ë kërkohet që të përcaktohet vendodhja e magazinës të jetë brenda qarkut Tiranë.
  - d) Operatori ekonomik duhet të dorëzojë vërtetimin e realizimit të kontratës për kontrata të lidhura me autoritete kontraktore. Operatori ekonomik ka paraqitur kontratën dhe faturat tatimore por nuk ka paraqitur vërtetimin e realizimit të kontratës lëshuar nga Autoriteti Kontraktor.
  - e) Listëpagesat për punonjësit të paraqitura nuk janë të konfirmuara nga organet tatimore sipas kërkesave të DST. Gjithashtu dhe për punonjësit e siguruar nuk ka paraqitur vërtetim nga Inspektoriat Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore sipas kërkesave të DST.
  - f) Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument që vërteton dëshmitë për mjetet e pajisjet teknike të cilat shërbejnë për çarje dhe prerje të druve të zjarrit, përveç disa fotove të mjeteve e pajisjeve.
  - g) Nga gjendja e magazinës e paraqitur nga operatori ekonomik, rezulton se në magazinë ndodhen 755 mst dru zjarri, ndërkohë në DST-ë është kërkuar më shumë.
  - h) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë çertifikatat e punonjësve për përdorimin e makinerive dhe mjeteve prerëse të lëshuara nga organet kompetente, operatori ekonomik Gjergj Buça nuk i ka paraqitur.
  - i) Kontrata me D.SH.P është kontratë e lidhur mes Nikolin Gjacit dhe D.SH.P. dhe jo operatorit ekonomik Gjergj Buçaj.
  - j) Gjithashtu kontrata me D.SH.P është kontratë e lidhur mes Nikolin Gjacit dhe D.SH.P.
  - k) Kontrata e bashkëpunimit mes Gjergj Buça-jt dhe Nikolin Gjaci nuk është i formuluar në përputhje me kërkesat ligjore të cilat përcaktojnë dhe mënyrën e realizimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, Operatorin ekonomik; **“ALCANI” Sh.p.k me NIPT J91505006Q**, me seli ne Adresa: Rruga “Frutikulturës”, Kamëz, Tirane, se oferta me vlerë **6,013,060 (gjashtë milion e trembëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSH**, e paraqitur për tenderin me objekt **“Blerje dru zjarri dhe shperndarje ne objektet shkollore dhe parashkollore”**, me afat të kryerjes së shërbimeve deri 31.12.2016 nga nënshkrimi i kontratës, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit, Tiranë, Rruga 5 maji, pranë Tregut të Medresesë**, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe procedura e prokurimit do të anulohet, sipas të ligjit Nr.9643 date 20.11.2006 “Për prokurimet publike”.

### Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 25/08/2016

Ankesa: S`ka pasur

## SHA UJESJELLESË FSHAT ELBASAN FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: [Zeqiri sh.p.k.]

Procedura e prokurimit: Kerkese per propozim

Përshkrim i shkurtër i kontratës: BLERJE TUBO HDPE PER NEVOJAT E NDERRMARRJES UJESJELLESË FSHAT ELBASAN me vlere 3429000 (tre milion e katerqind e njeset e nente mije ) leke, pa tvsh me afat deri 15 dite]. Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [08.08.2016] [Numri 31]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- |  |                 |
|--|-----------------|
| 1. Euro – Alb  | K66613407H      |
| Emri i plotë i shoqërisë   | numri i NIPT-it |
| 3290000 leke (tre milion e dyqind e nentedhjetë mije leke) pa TVSH<br>(me numra dhe fjalë) |                 |
| 2. Frutibest sh.p.k.   | S`ka            |
| Emri i plotë i shoqërisë   | numri i NIPT-it |
| Nuk ka paraqitur oferte<br>(me numra dhe fjalë)  |                 |
| 3. Jordil sh.a.  | K13506401C      |
| Emri i plotë i shoqërisë   | numri i NIPT-it |
| 2879500 leke (dy million e teteqind e shtatedhjetë e nente mije e peseqind leke)           |                 |
| 4. Alen-Co sh.p.k.   | K83213401M      |
| Emri i plotë i shoqërisë   | numri i NIPT-it |
| 3087000 leke (tre milion e tetëdhjetë e shtatë mije leke)                                  |                 |
| 5. Ekspo Sistem sh.p.k.  | S`ka            |
| Emri i plotë i shoqërisë   | numri i NIPT-it |
| Nuk ka paraqitur oferte<br>(me numra dhe fjalë)  |                 |
| 6. Zeqiri sh.p.k.  | J67902827A      |
| Emri i plotë i shoqërisë   | numri i NIPT-it |
| 2990000 leke (dy million e nenteqind e nentedhjetë mije leke)                              |                 |

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- I. Frutibest per arsyet e meposhtme:
  1. Ska preventive

## 2. Ska dokumentacion kualifikues

## II. Jordil sh.a. per arsyet e meposhtme

1. Shoqeria nuk ka te specifikuar ne QKB tregtimin e mallrave objekt prokurimi ne kundershtim me kerkesat e vecanta per kualifikim ku specifikohet: Operatori ekonomik duhet te jete i regjistruar ne regjistrat perkates profesionale ose tregtare sipas QKB i afte per tregtimin e mallrave te specifikuar ne DT.
2. Subjekti rezulton me detyrime te papaguara ne kundershtim me kerkesat e pergjithshme per kualifikim ku percaktohet:
  1. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):
    - a) ka plotësuar detyrimet fiskale,
    - b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore ,  
te lëshuar nga Administrata Tatimore.

## III. Ekspo Sistem per arsyet e meposhtme:

1. Ska preventive
2. Ska dokumentacion kualifikues

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Zeqiri sh.p.k. me adrese Fier se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 2990000 leke (dy million e nenteqind e nentedhete mije leke) pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Sh.a. Ujesjellesi Fshat Elbasan sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [3087000 leke (tre milion e tetedhete e shtate mije leke)], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 25.08.2016

Ankesa: Jo

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**TIRANA PARKING/BASHKIA TIRANË**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Nga: **Tirana Parking/Bashkia Tiranë**

**Drejtuar:** Operatorit Ekonomik Infrakonsult sh.p.k. , Lagjja "Kryengritja", TIRANE Njesia Bashkiake nr.8, rruga "Qemal Stafa", pallati 25, hyrja 4, apartamenti 4, perballe Qendres Lincoln.

Procedura e prokurimit: “Mbikqyrje e punimeve Civile te ndertimit te parkimit tek fusha e sportit “Qytet Studenti” Tirane ”, në vlerën **567,045** (peseqind e gjashtedhete e shtate mije e dyzet e pese) Lek pa TVSH.

Burimi i Financimit: Fondet vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Tiranë për vitin 2016, miratuar me VKB Nr.58, datë 30.12.2015 “Për miratimin e programit buxhetor afat-mesëm 2016 – 2018 dhe detajimin e buxhetit të Tirana Parking për vitin 2016. Janë planifikuar fonde për realizimin e punëve me objektin **Mbikqyrje e punimeve Civile te ndertimit te parkimit tek fusha e sportit “Qytet Studenti” Tirane .**

Kohëzgjatja e kontratës : 60 ditë

Loti i pare : “Mbikqyrje e punimeve Civile te ndertimit te parkimit tek fusha e sportit “Qytet Studenti” Tirane ”, në vlerën **567,045** (peseqind e gjashtedhete e shtate mije e dyzet e pese) Lek pa TVSH

Publikime të mëparshme: Po, botimi në buletin nr.33, datë 22.08.2016, shpallja ne website e APP-se, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: *çmimi më i ulët X*,

Njoftojmë se ka kanë marrë pjesë Operatorët ekonomik si më poshtë:

| Nr. | Operatorët Ekonomik     | Vlera e Ofertës             | NUIS       |
|-----|-------------------------|-----------------------------|------------|
| 1   | DRICONS sh.p.k          | <b>110,000 Lekë Pa TVSH</b> | L52013020H |
| 2   | HE& SK 11 11 sh.p.k     | <b>100,000 Lekë Pa TVSH</b> | L19008502B |
| 3   | Infrakonsult sh.p.k     | <b>250,000 Lekë Pa TVSH</b> | L21512022F |
| 4   | A.sh.Engineering sh.p.k | <b>300,000 Lekë Pa TVSH</b> | L31617003F |
| 5   | NORD-COMAT sh.p.k       | <b>485,000 Lekë Pa TVSH</b> | L08501501Q |

\*Eshtë kualifikuar operatori Ekonomik :

**1. Infrakonsult sh.p.k .**

\* Jane skualifikuar keto operatore ekonomike.

\* **Operatori ekonomik DRICONS sh.p.k rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:**

- Kopje te deklarimit te xhiros vjetore gjate 3 (tre) viteve te fundit ku disponon vetem Bilancin 2015
- Nuk ka pune te ngjashme
- Te punimet e ngjashme nuk ka dorezuar Vertetimin nga institucioni me te cilen jan nenshkruar keto kontrata
- Mungon Arkitekti ne Listpagesat e shqoqerise

\* **Operatori ekonomik HE&SK 11 11 sh.p.k rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:**

- Kopje te certefikuara te bilanceve te 3 (tre) viteve te fundit , pasi mungon Certifikimi nga Tatimet ne disa prej faqeve te Bilancit te 2014 dhe 2015

**\* Operatori ekonomik NORD – COMAT sh.p.k rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:**

- Mungojne pune te ngjashme , pasi nuk disponin Kontrate
- Ne stafin e shoqerise nuk disponon kopje te Diplomes te Inxhinierit Mekanik

**\* Operatori ekonomik A.sh.Engineering sh.p.k rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:**

- Nuk ploteson punesimin mesatar prej 8 persona
- Mungon Arkitekti ne listpagesat e shoqerise

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik **“Infrakonsult.”** se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej: **250,000** (dyqind e pesedhjetë mijë) Lek pa TVSH **është identifikuar si ofertë e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Tirana Parking, me adresë: Rruga: “Ali Begeja”, Nd.16, Kodi Postar 1017, Tiranë, sigurimin e ofertës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5(pesë) ditëve qe nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike nr.9643 date 20.11.2006 , i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 26.08.2016  
Ankesa: Nuk ka.

### **TIRANA PARKING/BASHKIA TIRANË** **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Nga: **Tirana Parking/Bashkia Tiranë**

**Drejtuar:** Operatorit Ekonomik Infrakonsult sh.p.k. , Lagjja "Kryengritja", TIRANE Njesia Bashkiake nr.8, rruga "Qemal Stafa", pallati 25, hyrja 4, apartamenti 4, perballe Qendres Lincoln.

**Procedura e prokurimit: Mbikqyrje e punimeve Civile te ndertimit te parkimit tek Pallati i Sportit “Asllan Rusi” Tirane**, ne vleren **539,264** (peseqind e tridhjetë e nente mijë e dyqind e gjashtedhjetë e kater) Lek pa TVSH

**Burimi i Financimit:** Fondet vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Tiranë për vitin 2016, miratuar me VKB Nr.58, datë 30.12.2015 “Për miratimin e programit buxhetor afat-mesëm 2016 – 2018 dhe detajimin e buxhetit të Tirana Parking për vitin 2016. Janë planifikuar fonde për

realizimin e punëve me objektin : “Mbikqyrje e punimeve Civile te ndertimit te parkimit tek Pallati i Sportit Asllan Rusi Tirane”.

Kohëzgjatja e kontratës : 60 ditë

Loti i dytë: “Mbikqyrje e punimeve Civile te ndertimit te parkimit tek Pallati i Sportit Asllan Rusi Tirane”, ne vleren **539,264** (peseqind e tridhjetë e nente mije e dyqind e gjashtedhjetë e kater) Lek pa TVSH

Publikime të mëparshme: Po, botimi në buletin nr.33, datë 22.08.2016, shpallja ne website e APP-se, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: *çmimi më i ulët X*,

Njoftojmë se ka kanë marrë pjesë Operatorët ekonomik si më poshtë:

| Nr. | Operatorët Ekonomik | Vlera e Ofertës             | NUIS       |
|-----|---------------------|-----------------------------|------------|
| 1   | DRICONS sh.p.k      | <b>110,000 Lekë Pa TVSH</b> | L52013020H |
| 2   | HE& SK 11 11 sh.p.k | <b>100,000 Lekë Pa TVSH</b> | L19008502B |
| 3   | Infrakonsult sh.p.k | <b>250,000 Lekë Pa TVSH</b> | L21512022F |
| 4   | NORD-COMAT sh.p.k   | <b>485,000 Lekë Pa TVSH</b> | L08501501Q |

\*Eshtë kualifikuar operatori Ekonomik :

**1. Infrakonsult sh.p.k .**

\* Jane skualifikuar keto operatore ekonomike.

\* **Operatori ekonomik DRICONS sh.p.k rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:**

- Kopje te deklarimit te xhiros vjetore gjate 3 (tre) viteve te fundit ku disponon vetem Bilancin 2015
- Nuk ka pune te ngjashme
- Te punimet e ngjashme nuk ka dorezuar Vertetimin nga institucioni me te cilen jan nenshkuar keto kontrata
- Mungon Arkitekti ne Listpagesat e shqoqerise

\* **Operatori ekonomik HE&SK 11 11 sh.p.k rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:**

- Kopje te certefikuara te bilanceve te 3 (tre) viteve te fundit , pasi mungon Certefikimi nga Tatimet ne disa prej faqeve te Bilancit te 2014 dhe 2015

\* **Operatori ekonomik NORD – COMAT sh.p.k rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:**

- Mungojne pune te ngjashme , pasi nuk disponin Kontrate
- Ne stafin e shoqerise nuk disponon kopje te Diplomes te Inxhinierit Mekanik

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik **“Infrakonsult.”** se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej: **250,000** (dyqind e pesedhjetë mijë) Lek pa TVSH është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Tirana Parking, me adresë: Rruga: “Ali Begeja”, Nd.16, Kodi Postar 1017, Tiranë, sigurimin e ofertës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5(pesë) ditëve qe nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike nr.9643 date 20.11.2006 , i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 26.08.2016

Ankesa: Nuk ka.

## **BASHKIA KOLONJË** **FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

**Data: 05 / 09 / 2016**

**Për: Infosoft Systems Sh.p.k**

**Adresa:** Tiranë , Rruga Murat Toptani,Gjergji Center

**Procedura e prokurimit:** Procedura **Kërkesë për Propozim** me mjete elektronike

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** **“Blerje paisje kompjuterike dhe fotokopje”**

**Burimi i financimit:** Vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Kolonjë për vitin 2016, miratuar me VKB Nr.7,datë.13.02.2016 “Për Miratimin e buxhetit të vitit 2016 ”. **Transferta e Pakushtëzuar .**

**Fondi limit pa TVSH: 1 500 000 ( Njëmilionepesëqindmijë ) lekë pa tvsh.**

**Afati për realizimin e shërbimit : 10 ( dhjetë ) ditë nga nënshkrimi i kontratës .**

**Publikime të mëparshme :** Buletini i Njoftimeve Publike *DATA 27/06/2016 NR.25*

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

**Data e zhvillimit të tenderit/Hapja e ofertave:** 07 / 07 /2016, ora 11 : 00

**Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

**1. PC Store shpk**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**L 01606034 A**

*numri i Nuis-it*

Vlera **1 263 350 (Njëmilionedyqindegjashtëdhjetëetremijëetreqindpesëdhjetë) lekë pa Tvsh .**

*(me numra dhe fjalë)*



**2. BNT Electronic's shpk***Emri i plotë i shoqërisë*

Vlera **1 213 450** (*Njëmilionedyqindetrembëdhjetëmijëekatërqindepesëdhjetë*) **lekë pa Tvsh** .  
(*me numra dhe fjalë*)

**J 61817047 D***numri i Nuis-it***3. Infosoft Systems Sh.p.k***Emri i plotë i shoqërisë*

Vlera **1 476 105** (*Njëmilionekatërqindeshatatëdhjetëegjashtëmijëenjëqindepesë*) **lekë pa Tvsh** .  
(*me numra dhe fjalë*)

**J 61820021 C***numri i Nuis-it*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 , “ **Për Prokurimin Publik** ”, ( i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “**Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik**”, si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik **Infosoft Systems shpk**, nga ku rezultoi se oferta përmbush të gjitha kriteret për kualifikim të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pas kualifikimit të operatorit ekonomik verifikoi ofertën **për gabime aritmetike** në mbështetje të të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu VII Neni 66, pika 4 dhe konstatoi se vlera e ofertës të paraqitur nga operator ekonomik

**1 476 105** ( Njëmilionekatërqindeshatatëdhjetëegjashtëmijëe njëqindepesë) **lekë pa Tvsh** është paraqitur **pa gabime** aritmetike në vlera.

Sa më sipër pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik si dhe verifikimit të ofertës për gabime aritmetike Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e operatorit ekonomik: **Infosoft Systems shpk**, është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur **ofertë të vlefshme**.

**Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

- 1.Operatori Ekonomik PC STORE shpk
- 2.Operatori Ekonomik BNT ELECTRONIC’S shpk .

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:****1. Operatori Ekonomik PC Store shpk**

a.Në kriteret e veçanta të kualifikimit **kapaciteti profesional** pika **2 dhe 3** kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si me poshtë :

**-Operatori Ekonomik duhet të ketë një specialist të akredituar në platforma printimi nga prodhues boterore.**

**-Operatori Ekonomik duhet të ketë një specialist të kualifikuar për Desktops dhe Workstations.** Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik **PC Store shpk** çertifikatat që vërtetojnë specializimet janë të panoterizuara dhe të pa përkthyer.

**b.**Në kriteret e veçanta të kualifikimit **kapaciteti profesional** pika **5** kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si me poshtë :

**-Operatori ekonomik duhet të ketë autorizim prodhuesi (MAF) për shitje dhe shërbim (mirembajtje ose riparim) për produktet e ofruara.**

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik **PC Store shpk** autorizimet e prodhuesit, MAF i dorëzuar nga Xerox është lëshuar vetëm për shitje dhe jo për shërbim (mirembajtje ose riparim) sic kërkohej në dokumentet e tenderit. Gjithashtu te MAF të dorëzuar mungojnë vërtetimet e perkthimit për secilin prej tyre, për t'u kualifikuar si të vlefshëm sipas ligjit noterial për kopjet e noterizuara.

**c.**Në kriteret e veçanta të kualifikimit **kapaciteti profesional** pika **6** kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si me poshtë :

**-Operatori ekonomik në ofertën ekonomike dhe teknike duhet të përshkruajë markën dhe modelin e pajisjes që kuoton.**

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik **PC Store shpk** bazuar në **pikën 6 për ofertën teknike**, pas shqyrtimit të saj u vunë re mangësitë dhe jokonformitetet si më poshtë:

- Për pajisjen e ofruar Xerox WorkCentre 5335, nuk ploteson Memorjen  $\geq 3$  GB (memorja ne katalog eshte 1 GB dhe maksimumi që mund të shtohet është deri në (2GB),si dhe nuk plotesohet kapaciteti i HDD 320GB (HDD në katalog është 160(GB)

- Për Kompjuter Deskop 1, është ofruar modeli HP 280 G2 i cili nuk ploteson numrin e portave "slots" PCI/PCIE sipas kërkesës. Në katalog shprehet: "1 PCIE x1; 1 PCIE x16; 1 PCI (optional)". Varianti opsional plotesohet vetëm në modelin HP 280 Pro G2 dhe jo në modelin HP 280 G2 të ofruar nga ju. Monitori i ofruar HP P222VA nuk ploteson kohën e rifreskimit(Response Time)5 ms,në katalog është shprehur 8ms.

- Për Kompjuter Deskop 2, është ofruar modeli HP 280 G2 i cili nuk ploteson numrin e portave "slots" PCI/PCIE sipas kërkesës. Në katalog shprehet së karta grafike është e integruar dhe nuk ka opsione shtimi karte grafike opsionale. Në ofertën teknike nuk është vendosur modeli i kartës grafike të dedikuar që është shtuar, për të verifikuar kartat grafike të suportuara në këtë model, dhe portat përkatëse VGA sipas kërkesës min (2) porta (VGA/DVI/HDMI/DP).

Monitori i ofruar HP P222VA nuk plotëson kohën e rifreskimit (Response Time) 5 ms, në katalog është shprehur 8 ms.

- Për Kompjuter Workstation Advanced, është ofruar modeli HP Z240 Workstation, i cili nuk suporton memorje ECC nëse është konfiguruar me procesorin e ofertuar Core i7-6700 @3.4GHz. Kjo është e verifikuar sipas Intelit në linkun [http://ark.intel.com/products/88196/Intel-Core-i7-6700-Processor-8M-Cache-up-to-4\\_00-GHz](http://ark.intel.com/products/88196/Intel-Core-i7-6700-Processor-8M-Cache-up-to-4_00-GHz)

Refefuar kërkesës për storage controller i cili të suportoje RAID 1, 5, pas verifikimeve u konstatua që modeli i ofruar Z240, nuk suporton RAID 5.

Nuk është identifikuar karta grafike e dedikuar në ofertën teknike, për të verifikuar dhe portat përkatëse, ndërkohë që në katalog janë nënvizuar "e integruar, Nvidia NVS 310, AMD FirePro W2100" që bie në kundërshtim me kërkesën që të markohen qartë në katalog për të kryer verifikimet e duhura.

Sipas katalogut workstation është vetëm me një kartë rrjeti RJ45 dhe nuk është e specifikuar qartë, cila është karta e rrjetit e shtuar, dhe nëse plotëson portat RJ45 të kërkuara.

- Për UPS 600VA është ofruar PowerTree 650VA. 650VA është fuqia dalëse dhe jo modeli i UPS. Rrjedhimisht në katalog janë dhënë 5 modele UPS (S1250P, S650BX, S650B, S650L, S1250L), dhe asnjëra prej tyre nuk shpreh faktorin e fuqisë  $\geq 0.8$ .

Për më tepër, nuk është markuar katalogu sipas pikës 8 të kapacitetit profesional të kërkuar.

**d.**Në deklaratën e Garancive të produkteve të ofruara, garancia e produktit Kompjuter Advanced HP Z240 workstation është kërkuar 3 vjet, është ofruar 2 vjet.

Garancia e produktit UPS 600VA (PowerTree 650VA) është kërkuar 2 vjet është ofruar 1 vit.

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 3 dhe 5, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin publik" (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpalltë pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

## 2.Operatori Ekonomik BNT ELECTRONIC'S shpk .

**a.**Në kriteret e veçanta të kualifikimit **kapaciteti profesional** pika 5 kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

**-Operatori ekonomik duhet të ketë autorizim prodhuesi (MAF) për shitje dhe shërbim (mirembajtje ose riparim) për produktet e ofruara.**

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik **BNT Electronic's shpk** autorizimi i prodhuesit, **Kyocera** për produktin ECOSYS FS-1020MFP autorizon vetëm për shitje dhe jo "shërbim (mirëmbajtje ose riparim)" sic kërkohej në dokumentet e tenderit.

**b.**Në kriteret e veçanta të kualifikimit **kapaciteti profesional** pika 8 kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

-Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë ose broshurë për mallin që oferton (i përkthyer dhe noterizuar). Në katalog duhet të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt e kuotuar sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të kuotuar do të krahasohen me katalogun e paisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmëri të tyre).

- Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik **BNT Electronic's shpk** ka mos përmbushje të dokumentave standarte të tenderit (Specifikimet teknike) e cila kërkon qartë që “Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

-Dokumentacioni i dërguar nga ju , konkretisht deklarata e datës **13.07.2016**, nuk mund të merret në konsideratë nga anëtarët e komisionit të vlerësimit pasi në momentin e pranimit të dokumentacionit kjo deklaratë nuk është paraqitur nga ju.

Në shkresën e dërguar për sqarime më Nr.1745 Prot,datë.11.07.2016 kërkohej sqarim për të evidentuar në katalogun ose dokumentat e dërguara në sistem dhe jo deklarata apo dokumentacione të tjera shtesë jashtë sistemit.

c.Në kriteret e veçanta të kualifikimit **kapaciteti profesional** pika **6** kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si me poshtë :

**-Operatori ekonomik në ofertën ekonomike dhe teknike duhet të përshkruajë markën dhe modelin e pajisjes që kuoton.**

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik **BNT Electronic's shpk** bazuar në **pikën 6 për ofertën teknike**, pas shqyrtimit të saj u vunë re mangësitë dhe jokonformitetet si më poshtë:

- Për pajisjen e ofruar Workstation Advanced Fujitsu Celcius M740, memorja RAM e kërkuar “32GB, min DDR3 1600MHz, ECC”, e ofruar dhe markuar në katalogun e dërguar nga operatori juaj është 16GB DDR4 ECC, 2, 133 MHz, PC4-2133.

-Sqarimi juaj në “Kthim Përgjigjen” e datës 13.07.2016, në lidhje me kartën grafike të Workstation M740, NVidia Quadro K420, nuk qendron. Pas verifikimeve të katalogut të dërguar nga ju dhe informacioneve në faqen e prodhuesit në linkun <http://www.fujitsu.com/fts/products/computing/pc/workstations/celsius-m740-ll/>, kjo kartë ka memorje 1GB, dhe jo 2 GB sic është shprehur nga ju dhe e kërkuar në DST.

-Në lidhje me portat e kërkuara Min (2) porta (VGA/DVI/HDMI/DP) nuk janë të evidentuara dhe të shprehura në katalog. Sipas kthim përgjigjes suaj datë 13.07.2016, informacioni është i nënvizuar në faqen 5 dhe 6 të katalogut,por nga verifikimi i dokumentit nuk u gjet asnjë e dhënë për kriterin e portave të kërkuara “(2) porta (VGA/DVI/HDMI/DP)”. Në këto kushte produkti nuk përmbush specifikimet.

- Për pajisjen e ofruar UPS 600 VA Infosec X2 700VA ,**fuqia power “Power Factor” e kërkuar  $\geq 0.8$** ,e ofruar dhe markuar në katalogun e dërguar nga operatori juaj është  $\geq 0.5$

Koha e Transferimit “Transfer Time”  $\leq 4$  ms nuk është e shprehur në katalog. Ky është një specifikim bazë dhe i rëndësishëm për funksionalitetin e një UPS dhe prandaj duhej evidentuar me patjetër në katalog.

Në këto kushte produkti nuk përmbush specifikimet.

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Neni 53 pika 3 dhe 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **20.07.2016**.

Ankesa: **PO**

Brenda afatit ligjor për paraqitjen e ankesave, u paraqit një ankesë si më poshtë vijon:

**1. Operatori ekonomik BNT Electronic’s shpk**, me nr NIUS J **61817047 D**, me administrator **z. Jovan Bojdani**, është ankuar më datë **26/07/2016** mbi arsyet e skualifikimit të lart përmendura, pranë Bashkisë Kolonjë.

Autoritetit Kontraktor i ka kthyer përgjigje me shkresën Nr. 1916 date 29/07/2016 duke refuzuar ankesën.

Komisioni i Prokurimit Publik, na vë në dijeni se ky operator ekonomik ka vazhduar me tej me shkallet e ankimimit dhe me vendim nr. 1820/1 Prot, datë 08.08.2016 protokolluar me tonën nr. 2057 datë. 12.01.2016, urdhëron pezullimin e procedurës së prokurimit dhe shqyrtimin në themel të çështjes.

Me vendimin nr. 665/2016, të datës 26.08.2016, të Komisionit të Prokurimit Publik protokolluar në Bashkinë Kolonjë me nr. 2226 datë. 29 / 08 / 2016 jemi vënë në dijeni, se ne si Autoritet Kontraktor, na lejohet të vazhdojmë me hapat e mëtejshëm të kësaj procedure, pasi nuk është pranuar ankesa e operatorit **BNT Electronic’s shpk**.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **operatorin ekonomik Infosoft Systems Sh.p.k** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej/ **1 476 105** ( Një milionë katërqindeshtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e pesë) **lekë pa Tvsh** është identifikuar si oferta e **suksesshme**.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë

**Emri** Bashkisë Kolonjë  
**Adresa** Sheshi “ Rilindja ”  
**Tel/Fax** +355 812 2 2225 ; +355 812 2 3173  
**E-mail** bashkia.kolonje@gmail.com

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **30 (Tridhjetëditëve) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit

vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

**BASHKIA MAT**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

Burrel me 05/09/2016

**Për: ULEZA NDERTIMI SH.P.K** sh.p.k me Nipt:**J679029280** , Tirane , Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Zef Jubani,ndertesa 15, hyrja 19, apartamenti 1, kodi postar 1019.

Procedura e prokurimit: *Tender i Hapur.*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *Rehabilitim i Fasadave dhe sheshit te Qytetit Ulez(faza perbyllese)*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [01.08.2016] [30]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X,**

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. Uleza Ndertimi sh.p.k me**

Nipt:**L679029280**

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

**Vlera : 24,819,181** (njetzet e kater milion e teteqind e nentembedhjetë mijë e njeqind e tetedhjetë e nje ) leke, pa t.v.sh.

**2. DELIA IMPEX sh.p.k me**

Nipt:**K57123001R**

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

**Vlera : Ka paraqitur vetem nje dokument ne kete procedure Prokurimi(QKR)**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

**2. DELIA IMPEX sh.p.k me**

Nipt:**K57123001R**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

*Nuk ka paraqitur dokumenta per kete procedure prokurimi, I vetmi dokument I paraqitur eshte QKR*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **ULEZA NDERTIMI SH.P.K** sh.p.k me Nipt:**J679029280** , Tirane , Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Zef Jubani,ndertesa 15, hyrja 19, apartamenti 1, kodi postar 1019.se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 24,819,181 (njetzet e kater milion e teteqind e nentembedhjetë mijë e njeqind e tetedhjetë e nje ) leke, pa t.v.sh.. është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Bashkise Mat, Sheshi "Ahmet Zogu", Godina Nr.1 Burrel*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej \_\_\_\_\_ siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : 26.08.2016 .

Ankesa: nuk ka.

### **BASHKIA TIRANË** **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Drejtuar: Bashkimi i operatorëve ekonomikë "51N4E" degë e shoqërisë së huaj & "Geosat Group" shpk**

**Adresa: Rr. "Thanas Ziko", Ndërtesa në zonën kadastrale 8370, Njësia Bashkiake Nr. 8, Tiranë & "Dëshmorët 4 Shkurti" Pll i ri 19, Tiranë**

**Procedura e prokurimit: "Procedurë e Hapur" "Mbikqyrja e punimeve për objektin "Rikualifikim urban i Sheshit Skënderbej, Faza e I-rë"**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: "Mbikqyrja e punimeve për objektin "Rikualifikim urban i Sheshit Skënderbej, Faza e I-rë".**

**Fondi limit: 4,209,573 (katër milion e dyqind e nëntë mijë e pesëqind e shtatë dhjetë e tre) lekë pa TVSH.**

**Burimi i financimit:** vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2016, miratuar me Urdhër 23936, datë 03.08.2016 për "Detajimin dhe rishpërndarjen e fondit të investimeve brenda programit të Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik, programit të Arsimit Parauniversitar dhe Edukimit, programit të Strehimit dhe Planifikimit të Territorit, programit të Kulturës dhe Turizmit dhe programit të Planifikimit, Menaxhimit Administrimit për vitin 2016" dhe VKB-së Nr. 58, datë 30.12.2015 për "Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016" (i ndryshuar)".

**Kohëzgjatja e kontratës:** 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 01.08.2016, ora 10:00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 32 datë 15.08.2016.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “He&SK ”1111 shpk**

**NUIS L19008502B**

Vlera e ofertës = **1,600,000** (një milion e gjashtëqind mijë) lekë pa TVSH.

**2. Operatori ekonomik “A&E Engineering t” shpk**

**NUIS K72113010E**

Vlera e ofertës = **2,000,000** (dy milion)lekë pa TVSH.

**3. Operatori ekonomik “Zenit -06” shpk**

**NUIS K61731002D**

Vlera e ofertës = **2,255,000** (dy milion e dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH.

**4. Operatori ekonomik “Gjeoconsult & CO” shpk**

**NUIS K91810005U**

Vlera e ofertës = **2,800,000** (dy milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH.

**5. Operatori ekonomik “Tower” shpk**

**NUIS L21717003H**

Vlera e ofertës = **2,890,000** (dy milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë lekë pa TVSH.

**6. Operatori ekonomik “Derbi-E” shpk**

**NUIS K77916947A**

Vlera e ofertës = **2,900,000** (dy milion e nëntëqind mijë) lekë pa TVSH.

**7. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “51N4E” degë e shoqërisë së huaj & “Geosat Group” shpk**

**NUIS K82409002D & NUIS K21624005I**

Vlera e ofertës = **3,788,600** (tre milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH.

**8. Operatori ekonomik “Nord Comat” shpk**

**NUIS L08501501Q**

Vlera e ofertës = **3,990,000** (tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:**



**Përkatësisht për arsyt e mëposhtme:****1. Operatori ekonomik “HE&SK 1111” shpk**

- **Operatori ekonomik nuk ploteson piken 2.2 Kapaciteti Teknik të kriterëve të Vecanta të Kualifikimit** ”Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 1.683.829 (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e njëzet e nëntë) lekë pa TVSH, të realizuara gjatë tri viteve të fundit. Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë: a. Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin shoqëruar me situacionet për shërbimet e kryera dhe vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe te suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar. b. Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatese të shitjes (ku te shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara)”, pasi operatori ekonomik ka paraqitur si punime te ngjashme kontrata objektet e të cilave nuk kane punime te ngjashme me objektin qe po prokurohet, punime ne rruge dhe sheshe struktura speciale.

**2. Operatori ekonomik “A&E Engineering” shpk**

- **Operatori ekonomik nuk ploteson piken 2.2 Kapaciteti Teknik të kriterëve të Vecanta të Kualifikimit** ”Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 1.683.829 (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e njëzet e nëntë) lekë pa TVSH, të realizuara gjatë tri viteve të fundit. Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë: a. Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin shoqëruar me situacionet për shërbimet e kryera dhe vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe te suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar. b. Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatese të shitjes (ku te shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara)”, pasi operatori ekonomik ka paraqitur si punime te ngjashme kontrata objektet e secilave nuk kane punime te ngjashme me objektin qe po prokurohet, punime ne rruge dhe sheshe struktura speciale.

**3. Operatori ekonomik “Zenit-06” shpk**

- **Operatori ekonomik nuk ploteson piken 2.2 Kapaciteti Teknik të kriterëve të Vecanta të Kualifikimit** ”Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 1.683.829 (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e njëzet e nëntë) lekë pa TVSH, të realizuara gjatë tri viteve të fundit. Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë: a. Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin shoqëruar me situacionet për shërbimet e kryera dhe vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe te suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit,

vlera e shërbimit të realizuar. b. Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatëse të shitjes (ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara)”, pasi operatori ekonomik ka paraqitur si punime te ngjashme kontrata objektet e secilave nuk kane punime te ngjashme me objektin qe po prokurohet, punime sheshe struktura speciale.

#### 4. Operatori ekonomik “Gjeoconsult & CO” shpk

- Operatori ekonomik nuk ploteson piken 4 të Kapacitetit teknik të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit: “Një punësim mesatar i të paktën 9 (nëntë) personave, për periudhën Janar 2016 -Qershor 2016 të vërtetuar me; Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen Janar 2016 – Qershor 2016. List-pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2016 – Qershor 2016, shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”, pasi operatori ekonomik nuk ka paraqitur formularët e deklaramit te pagesave per periudhen e kerkuar.
- Operatori ekonomik nuk ploteson piken 10 të Kapacitetit teknik të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit; “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Certifikatë OHSAS 18001-2007 (e vlefshme) lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim me objekt: *supervizion rrugësh dhe ndërtesa civile. Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme*”, pasi operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentin e kerkuar.

#### 5. Operatori ekonomik “Tower” shpk

- Operatori ekonomik nuk ploteson piken 4 të Kapacitetit teknik të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit: “Një punësim mesatar i të paktën 9 (nëntë) personave, për periudhën Janar 2016 -Qershor 2016 të vërtetuar me a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen Janar 2016 – Qershor 2016. b) List-pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2016 – Qershor 2016, shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”, pasi operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentin e kerkuar
- Operatori ekonomik nuk ploteson piken 5,6,7 të Kapacitetit teknik të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit **pasi nuk ka paraqitur stafin e kërkuar sipas:** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar me eksperiencë pune kombëtare/ ndërkombëtare jo më pak se **10 (dhjetë) vjeçare** stafin teknik, si më poshtë:
  - 2 (dy) Arkitekt
  - 2 (dy) Inxhinier ndërtimi
  - 1 (një) Inxhinier hidroteknik
  - 2 (dy) Inxhinier topograf
  - 1 (një) Inxhinier Elektrik

*Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme për kohëzgjatjen e kontratës që prokurohet, diploma përkatëse, CV dhe letër referencë nga punëdhënësi ku të shprehen qartë adresa e selisë, adresa e-mail, numër telefoni, me qëllim që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësi verifikimi.*

Operatori ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të tij teknik një restaurator të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, liçencë profesionale personale, lëshuar nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit, për restaurimin e monumenteve të arkitekturës.

Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik, i cili do të mbikqyrë punimet në objekt; të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Librezë pune (përkatëse)
- b) CV përkatëse
- c) Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- d) Diplomë

- Operatori Operatori ekonomik nuk ploteson piken 8,9,10 të Kapacitetit teknik të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit **pasi nuk ka paraqitur Çertifikatat e kërkuara sipas :**

*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatë të cilësisë ISO 9001- 2008 (e vlefshme) lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim me objekt: supervizion rrugësh dhe ndërtesa civile. Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme.*

*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 14001-2004 (e vlefshme) lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim me objekt: supervizion rrugësh dhe ndërtesa civile. Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme.*

*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatë OHSAS 18001-2007 (e vlefshme) lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim me objekt: supervizion rrugësh dhe ndërtesa civile. Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme.*

## 6. Operatori ekonomik “Derbi-E” shpk

- Operatori Operatori ekonomik nuk ploteson piken 6 të Kapacitetit teknik të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimi ” *Operatori ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të tij teknik një restaurator të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, liçencë profesionale personale, lëshuar nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit, për restaurimin e monumenteve të arkitekturës*”, pasi **nuk ka paraqitur nje teknik restaurator me dokumentat perkatese te kerkuar.**
- Operatori Operatori ekonomik nuk ploteson piken 7 të Kapacitetit teknik të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit : “*Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik, i cili do të mbikqyrë punimet në objekt; të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm: a) Librezë pune (përkatëse)b)CV përkatëse, c)Kontratë pune e vlefshme (përkatëse), d)Diplomë*”, **pasi nuk ka paraqitur nje deklarate**

ku te percaktoje Drejtuesin Teknik per objektin bashkengjitur me dokumentat e kerkuara.

- Operatori Operatori ekonomik nuk ploteson piken 4 të Kapacitetit teknik të Kriereve të Vecanta të Kualifikimit; “Një punësim mesatar i të paktën **9 (nëntë) personave**, për periudhën **Janar 2016 -Qershor 2016** të vërtetuar me; a)Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen **Janar 2016 – Qershor 2016**, b)List-pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Janar 2016 – Qershor 2016**, **shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore**, pasi nuk ka paraqitur formularet e deklaramit te pagesave per sigurimet shoqerore dhe shendetesore per periudhen e kerkuar.
- Operatori Operatori ekonomik nuk ploteson piken 5 të Kapacitetit teknik të Kriereve të Vecanta të Kualifikimit; “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar me eksperiencë pune kombëtare/ ndërkombëtare jo më pak se **10 (dhjetë) vjeçare** stafin teknik, si më poshtë:
  - 2 (dy) Arkitekt
  - **2 (dy) Inxhinier ndërtimi**
  - 1 (një) Inxhinier hidroteknik
  - 2 (dy) Inxhinier topograf
  - 1 (një) Inxhinier Elektrik. Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme për kohëzgjatjen e kontratës që prokurohet, diploma përkatëse, CV dhe letër referencë nga punëdhënësi ku të shprehen qartë adresa e selisë, adresa e-mail, numër telefoni, me qëllim që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësi verifikimi”, **pasi inxhinieri i ndertimit Alban Qinami nuk ka 10 vite eksperience pune. Ai eshte diplomuar ne 2008.**

## 7. Operatori ekonomik “Nord Comat” shpk

- Operatori ekonomik nuk ploteson piken 1 të Kriereve të përgjithshme të kualifikimit Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

*Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):*

- nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)*
- nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,*
- nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional,*

*Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet te ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Keto kriteret (pikat 1,2) duhet te vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës», **pasi dokumenti i paraqitur eshte leshuar me pare se 3 muaj nga data e hapjes se tenderit.***

- Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 4 të Kriereve të vecanta të Kualifikimit: “Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë: Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”, **pasi operatori ekonomik nuk ka**

konfirmuar shlyerjen e te gjithë detyrimeve te matura te energjise elektrike ( konkretisht muajin qershor)

- **Operatori ekonomik nuk ploteson piken 2.2 Kapaciteti Teknik të kriterëve të Vecanta të Kualifikimit;** “Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **1.683.829** (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e njëzet e nëntë) lekë pa TVSH, të realizuara gjatë tri viteve të fundit.

**Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:**

- a) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin shoqëruar me situacionet për shërbimet e kryera dhe vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe te suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar.
- b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatëse të shitjes (ku te shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara).”

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimi i operatorëve ekonomikë “51N4E” degë e shoqërisë së huaj & “Geosat Group” shpk me adresë: Rr. “Thanas Ziko”, Ndërtesa në zonën kadastrale 8370, Njësia Bashkiake Nr. 8, Tiranë & “Dëshmorët 4 Shkurti” Pll i ri 19, Tiranë** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **3,788,600** (tre milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitörja “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 1, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë:** 26.08.2016

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.

## **BASHKIA DEVOLL** **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Data: 05. 09 .2016

**Për:** ERGI SHPK : Rruga: Autostrada Elbasan- Metalurgji, Km 3 prane Kendit sportiv PEPA Bradashesh Elbasan.

**Procedura e prokurimit:** Kerkese per Propozim-Mallra

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Objekti i kontratës “ *Blerje Matsa Uji*”

Kohezgjatja e kontrates: 30 dite kalendarike nga lidhja e kontrates,

Fondi limit: 5.831.019 (pese milion e tetqind e tridhjetë e një mijë e nentëmbëdhjetë ) lek pa t.v.sh (Granti)

Publikime të mëparshme : Buletini i Njoftimeve Publike [08.08.2016 ] [31]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët x

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. ERGI SHPK**

**K02727229**

Vlera: 5.513.730 (pese milion e peseqind e trembedhjetë mijë e shtateqind e tridhjetë) lek pa t.v.sh.

**2. BOLT SHPK**

**K91517011V**

Vlera: 5.209.206 (pese milion e dyqind e nente mijë e dyqind e gjashtë) lek pa tv.sh

**3. FAT GROUP SHPK**

**L43428401V**

Vlera: 5.459.900 (pese milion e katerqind e pesedhjetë e nente mijë e nenteqind) lek pa t.v.sh

**4. Boshnjaku B SHPK**

**K72627402H**

Vlera: 5.418.374 (pese milion e katerqind e tetembedhjetë mijë e treqind e shtatedhjetë e kater) lek pa t.v.sh

**5. COMFORT SHPK**

**J61901194M**

Vlera: 5.498.350 (pese milion e katerqind e nentedhjetë e tete mijë e treqind e pesedhjetë) lek pa t.v.sh.

**6. VASAA SHPK**

**J62903470T**

Vlera: 5.106.160 (pese milion e njeqind e gjashtë mijë e një qind e gjashtedhjetë) lek pa t.v.sh.

**7.PAERA SHPK**

**L31505034R**

Vlera: \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

**1. BOLT SHPK**

**K91517011V**

**2. FAT GROUP SHPK**

**L43428401V**

**3. Boshnjaku B SHPK**

**K72627402H**

**4. COMFORT SHPK**

**J61901194M**

**5. VASAA SHPK**

**J62903470T**

**6. PAERA SHPK**

**L31505034R**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik “**BOLT SHPK**” me NIPT **K91517011V**, me oferte ekonomike ne vlere: 5.209.206 lek pa t.v.sh u s’kualifikua, për shkak të arsyeve të mëposhtme :

- **Mungese dokumentacioni.** Operatori ekonomik nuk kishte ngarkuar ne sistemin elektronik te app.gov.al **1.**Certefikate origjine te mallit qe prokurohet **dhe 2.** Certefikate cilesie nga Prodhuesi per mallin qe prokurohet. Dokumenta Sipas kerkesave te hartuar nga Njesia e Prokurimit sipas shtojces 7 te DST.

2. Operatori Ekonomik “**FAT GROUP SHPK**” me NIPT **L43428401V** me oferte ekonomike me vlere 5.459.900 lek pa t.v.sh u s’kualifikua per shkak te arsyeve te meposhtme:

-**Mungese dokumentacioni.** Operatori ekonomik nuk kishte ngarkuar ne sistemin elektronik te app.gov.al **1.**Certefikaten origjine te mallit qe prokurohet **dhe 2.** Certefikate cilesie nga Prodhuesi per mallin qe prokurohet. Dokumenta Sipas kerkesave te hartuar nga Njesia e Prokurimit sipas shtojces 7 te DST

3. Operatori Ekonomik “**Boshnjaku B SHPK**” me NIPT **K72627402H** me oferte ekonomike me vlere 5.418.347 lek pa t.v.sh u s’kualifikua per shkak te arsyeve te meposhtme:

-**Mungese dokumentacioni.** Operatori ekonomik nuk kishte ngarkuar ne sistemin elektronik te app.gov.al **1.**Certefikaten origjine te mallit qe prokurohet **dhe 2.** Certefikate cilesie nga Prodhuesi per mallin qe prokurohet. Dokumenta Sipas kerkesave te hartuar nga Njesia e Prokurimit sipas shtojces 7 te DST

4. Operatori Ekonomik “**COMFORT SHPK**” me NIPT **J61901194M** me oferte ekonomike me vlere 5.498.350 lek pa t.v.sh u s’kualifikua per shkak te arsyeve te meposhtme:

-**Mungese dokumentacioni.** Operatori ekonomik nuk kishte ngarkuar ne sistemin elektronik te app.gov.al **1.**Certefikaten origjine te mallit qe prokurohet, Sipas kerkesave te hartuar nga Njesia e Prokurimit sipas shtojces 7 te DST

5. Operatori Ekonomik “**VASAA SHPK**” me NIPT **J62903470T** me oferte ekonomike me vlere 5.106.160 lek pa t.v.sh u s’kualifikua per shkak te arsyeve te meposhtme:

-**Mungese dokumentacioni.** Operatori ekonomik nuk kishte ngarkuar ne sistemin elektronik te app.gov.al **1.**”Certefikaten origjine te mallit qe prokurohet”, Sipas kerkesave te hartuar nga Njesia e Prokurimit sipas shtojces 7 te DST

6.Operatori Ekonomik “**PAERA SHPK**” me NIPT **L31505034R** me oferte ekonomike me vlere \_\_\_\_\_ lek pa t.v.sh u s’kualifikua per shkak te arsyeve te meposhtme:

-**Mungese dokumentacioni.** Operatori ekonomik ka ngarkuar ne sistemin elektronik te app.gov.al vetem:

a. dokumentin qe verteton se ( subjekti juaj) nuk eshte ne proces falimentimi (statusi aktiv)

. **Dokumentat e tjera te kerkuara nga Njesia e prokurimit sipas Shtojces 7 mungonin**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *operatorin ekonomik* „ **ERGI SHPK** me adrese selie: Autostrada Elbasan- Metalurgji km 3 prane kendit sportiv PEPA Bradashesh Elbasan se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 5.513.730 ( *pese milion e*

peseqinde e trembedhete mije e shtateqind e tridhete )lek pa tv.sh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *A.K Bashkia Devoll , lagjia nr 1 rruga 24 tetori, Bilisht* , sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 15 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme [nuk ka ofertues te dytë të kualifikuar], siç parashikohet në nenin 58, të ligjit për prokurimet publike nr. 9643 date 20.11.2006.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në date 05 . 09 .2016

Ankesa: ka ose jo JO

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**BASHKIA HIMARE**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Data 05/09/2016**

**Për: Operatorin Ekonomik “TEA-D & NIKA“ shpk K 32522629 L , Gjirokaster,Lagja “ 18 Shtatori “ pallati 11 katesh mbrapa “ Star “, kati i trete.**

Procedura e prokurimit:Procedurë E Hapur ( Elektronike ).

Përshkrim i shkurtër i kontratës:“**Rikualifikim Urban i Sheshit te Lukoves**”

1. Fondi limit:: **74.551.621** ( shtatedhete e kater milion e peseqinde e pesdhete e nje mije e gjashteqinde e njezete e nje leke pa tvsh)

Burimi i Financimit : Fondi i Zhvillimit te Rajoneve

Kohëzgjatja e kontratës 150 (Njeqinde e pesedhete) ditë kalendarike, afat i cili fillon nga data e nënshkrimit të kontratës .

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “ **SHENDELLI Shpk**“ me vlere 0 ( Nuk ka paraqitur asnje dokumentacion) .
2. “ **AVDULI shpk & Colombo Shpk** “ me vlere 70.817.632 ( shtatedhete milion e teteqinde e shtatembedhete mije e gjashteqinde e tridhete e dy leke) pa tvsh.
3. “ **B 93 shpk** “ me vlere 74.539.247 ( shtate dhete e kater milion e peseqinde e tridhete e nente mije e dyqinde e dyzete e shtate leke ) pa tvsh.
4. “**TEA-D & NIKA Shpk** me vlere 69.999.999 ( gjashtedhete e nente milion e nenteqinde e nentedhete e nente mije e nenteqinde e nentedhete e nente leke ) pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- **Operatori ekonomik “ Shendelli shpk “**  
0 ( Nuk ka paraqitur asnje dokumentacion)



**- Operatori ekonomik B 93 shpk**

74.539.247 ( shtatedhjete e kater million e peseqinde e tridhjete e nente mije e dyqinde e dyzete e shtate leke) pa tvsh.

**- Operatori ekonomik Avduli & Colombo Shpk**

70.817.632 ( shtatedhjete milion e teteqinde e shtatembedhjete mije e gjashteqinde e tridhjete e dy leke ) pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

**1. Operatori ekonomik “ Shendelli ” sh.p.k.**

është skualifikuar në këtë procedurë prokurimi , pasi :

nuk ploteson kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor.

**2. Operatori ekonomik “B 93 ” shpk eshte skualifikuar pasi nuk ploteson kriteret e vendosura nga AK-ja.****3. Operatori ekonomik “ Avduli & Colombo “ shpk eshte skualifikuar per arsye se nuk permbush kriteret e vendosura nga AK-ja.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “**TEA-D & NIKA“ shpk K 32522629 L , Gjirokaster,Lagja “ 18 Shtatori “ pallati 11 katesh mbrapa “ Star “, kati i trete,** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **69.999.999 ( gjashtedhjete e nente milion e nenteqinde e nentedhjete e nente mije e nenteqinde e nentedhjete e nente leke )** pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **BASHKIA HIMARE**, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, brenda 30 (TRIDHJETE) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 49 të ligjit nr.9643, date 20.11.2007 “Për prokurimin publik”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 26.08.2016.

Ankesa: ka ose jo : **JO NUK KA PATUR**

**BASHKIA PEQIN**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

**Data : 05/09/2016**

Nga: **Autoriteti Kontraktor Bashkia Peqin**  
**Adresa : Bulevardi “Mustafa Gjinishi” Peqin**

Për: **Operatorin ekonomik : Bashkimi i Shoqerive “Ergen” shpk & “Eurondertim 2000” shpk.**

Adresa : Karine, Peqin. Nipt. J69405118J dhe Nipt.K02003001O

\* \* \*

Procedura e prokurimit: **Procedure e Hapur me mjete elektronike**

Pershkrim i shkurter i kontrates: **Furnizim me uje te pijshem i NJ.A. KARINE.  
Kohezgjatja ne muaj 6 (gjashte) duke filluar nga data e nenshkrimimit te kontrates.**

Fondi limit: **21.821.453 (njezet e njemilion e teteqind e njezet e njemije e katerqind e pesedhjete e tre) leke pa tvsh.**

Burimi i financimit: **Buxheti i Shtetit**

Data e zhvillimit te procedures se prokurimit: **08.08.2016, Ora 09.00.**

Publikime te meparshme (nese zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Data \_\_.\_\_.\_\_\_\_, Numri  
—

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

**1. Bashkimi i Shoqerive “Elira” shpk & “Be-is” shpk  
J63423410S K71412003A**

- Vlera **15.384.023 leke (pesembedhjetemilion e treqind e tetedhjete e katermije e njezet e tre) (pa tvsh)**

**2. Bashkimi i Shoqerive “Liqeni VII” shpk & “Ilmed Konstruksion” shpk  
K01730502W K32521402Q**

- Vlera **15.956.496 leke (pesembedhjetemilion e nenteqind e pesedhjete e gjashtemije e katerqind e nentedhjete e gjashte) (pa tvsh)**

**3. “Ergi” shpk : K02707229P**

- Vlera **21.006.711 (njezet e njemilion e gjashtemije e shtateqind e njembedhjete) leke (pa tvsh)**

**4. “Fled” shpk : K16721104C**

- Nuk ka paraqitur Formularin e Ofertes ekonomike

**5. “Boshnjaku. B” shpk: K72627402H**

- Vlera **16.018.540 (gjashtembedhjetemilion e tetembedhjetemije e peseqind e dyzet) leke (pa tvsh)**

**6. Bashkimi i Shoqerive “Ergen” shpk & “Eurondertim 2000” shpk.****J69405118J K02003001O**

- Vlera **20.482.121 (njetzëtmilion e katerqind e tetedhjetë e dymije e njeqind e njetzë e nje) leke** (pa tvsh)

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:

**1. Bashkimi i Shoqerive “Elira” shpk & “Be-is” shpk**

Nuk jane dorezuar/paraqitur:

1. Operatori ekonomik Elira shpk. nuk ka paraqitur vertetim per xhiron vjetore nga Drejtoria Rajonale Tatimore perkatese per vitet 2014-2015 .
2. Operatori ekonomik Elira shpk. nuk ka paraqitur vertetim per numrin e punonjesve per periudhen Janar 2015 - Maj 2016.
3. Operatori ekonomik Elira shpk. nuk ka paraqitur liste-pagesen e punonjesve per periudhen Maj 2016.
4. Deklarimet e te dy operatoreve ekonomik me bashkim te perkohshem Elira shpk. & Be-is shpk. ne lidhje me shtojcen 9 mbi disponueshmerine e mjeteve eshte e pasakte dhe nuk perputhet me dokumentacionin e paraqitur. Konkretisht nuk jane paraqitur dokumentat ligjore per 5 kamione vetshkarkues, por vetem per 2 kamione qe jane me targa AA451MF dhe AA753LO. Ne deklaraten e disponueshmerise se mjeteve jane paraqitur si te disponueshme mjete per te cilat nuk eshte paraqit asnje lloj dokumenti. Kamioni me targa TR2656F i paraqitur ne deklaraten e disponueshmerise se mjeteve te makinerive nuk eshte te pronesise se operatorit ekonomik Elira shpk., por ne pronesi te Z.Sotiraq Kola.
5. Deklarata mbi disponueshmerine e mjeteve e dorezuar nga ana e operatorit ekonomik Be-is shpk. eshte e pa firmosur nga administratori dhe e pavulusur me vulen e shoqerise. Ne kete rast kjo deklarate konsiderohet si e padorezuar, gje qe eshte ne kundërshtim me kerkesat e kerkuar ne Kriteret e Pergjithshme dhe Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, te percaktuara ne DST te tenderit “Furnizim me uje te pijshem i NJ.A.Karine”.

**2. Bashkimi i Shoqerive “Liqeni VII” shpk & “Imed Konstruksion” shpk**

Nuk jane dorezuar/paraqitur:

1. Operatori ekonomik Liqeni VII shpk. nuk disponon ne Licensen e shoqerise Kategorine NS-20/A, “shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime per uje”.
  2. Ne kontraten e bashkepunimit te perkohshem, te dates 29/07/2016, me nr.3135 Rep dhe 1175/1 Kol te lidhur midis operatoreve ekonomik Liqeni VII dhe Imed Konstruksion shpk. eshte rene dakort qe ne ndarjen e punimeve shpimin e puseve ta beje operatori ekonomik Liqeni VII shpk, operator i cili nuk eshte i licencuar ligjerisht per nje gje te tille.
  2. Deklarata mbi disponueshmerine e makinerive sipas shtojces 9, e paraqitur nga operatori ekonomik Liqeni VII shpk. nuk eshte ne funksion te prokurimit "Furnizim me uje te pijshem i NJ.A. Karine" te autoritetit prokurues Bashkia Peqin, por eshte per "Rehabilitim i rezervuarit Malaj-2 me skemen ujitese ne Bashkine Mirdite.
- Nisur nga ky fakt operatoret ekonomike te mesiperm nuk kane paraqitur deshmi te mjaftueshme qe zoterojne mjetet teknike per realizimin e punimeve,

gje qe eshte ne kundershtim me kerkesat e kerkuar ne Kriteret e Pergjithshme dhe Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, te percaktuara ne DST te tenderit "Furnizim me uje te pijshem i NJ.A.Karine".

### 3. Operatori ekonomik "Ergi" shpk.

Nuk jane dorezuar/paraqitur:

1. Operatori ekonomik Ergi shpk. nuk ka paraqitur deklaraten e disponimit te mjeteve duke bere te pamundur ne kete menyre vleresimin e kapacitetit teknik te tij.

2. Operatori ekonomik Ergi shpk. nuk ka paraqitur Licencen mjedisore te tipit C III.1A.

3. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur numrin e mjaftueshem te elektriciteve te kerkuar ne dokumentat e tenderit ku nga 2 (dy) qe kerkohen ka paraqitur 1 (nje).

gje qe eshte ne kundershtim me kerkesat e kerkuar ne Kriteret e Pergjithshme dhe Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, te percaktuara ne DST te tenderit "Furnizim me uje te pijshem i NJ.A.Karine".

### 4. Operatori ekonomik "Fled" shpk.

Nuk jane dorezuar/paraqitur:

1. Formulari i ofertes ekonomike

2. Dokumentacioni administrativo-ligjor-kualifikues i kerkuar,

gje qe eshte ne kundershtim me kerkesat e kerkuar ne Kriteret e Pergjithshme dhe Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, te percaktuara ne DST te tenderit "Furnizim me uje te pijshem i NJ.A.Karine".

### 5. Operatori ekonomik "Boshnjaku. B" shpk.

1. Operatori ekonomik "Boshnjaku. B" shpk. me dt. 16.08.2016, dorezoi prane K.V.O, te autoritetit kontraktor Bashkise Peqin, deklaraten noteriale dt. 16.08.2016, me nr.1529.rep dhe nr.632.kol. ku deklaronte se me vullnetin e plote dhe te lire ben terheqjen e ofertes nga vazhdimi i metejshem i procedures se prokurimit Furnizim me uje te pijshem i NJ.A.Karine".

\* \* \*

Duke ju referuar procedures se larpermendur, informojme operatorin ekonomik **Bashkimi i Shoqerive "Ergen" shpk & "Eurondertim 2000" shpk. me seli, Karine, Peqin**, se oferta e paraqitur, me nje vlere te pergjithshme prej **20.482.121 (njezetmilion e katerqind e tetedhjetë e dymije e njeqind e njezet e nje) leke pa tvsh** eshte identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur te paraqisni prane **Autoritetit Kontraktor Bashkise Peqin, me adrese Bulevardi "Mustafa Gjinishi" Peqin** kopjen e nenshkruar te formularit te kontrates dhe te sigurimit te kontrates, sic parashikohet ne dokumentat e tenderit, brenda 30(tridhjetë) diteve nga dita e marrjes se ketij njoftimi.

Ne rast se nuk pajtoheni me kete kerkese, ose terhiqeni nga nenshkrimi i kontrates, do te konfiskohet sigurimi i ofertes suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues ne klasifikimin perfundimtar, oferta e te cilit eshte dorezuar me nje vlere te pergjithshme prej ( ) *leke pa tvsh*, sic parashikohet ne nenin 58 te ligjit per prokurimet publike nr.9643 date 20.11.2006.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **17.08.2016**

Ankesa: **Po ka pasur**

Jashtë afateve ligjore të parashikuara nga ligji për prokurimet publike nr.9643 datë 20.11.2006 ka paraqitur ankesë operatori ekonomik **Bashkimi i Shoqerive “Elira” shpk & “Be-is” shpk.**

Në zbatim të ligjit për prokurimet publike nr.9643 datë 20.11.2006 është trajtuar ankesa dhe i është kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimes **Bashkimi i Shoqerive “Elira” shpk & “Be-is” shpk** me datë 26.08.2016.

**BASHKIA BELSH**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

Data: 05.09.2016

Për: Operatori ekonomik **“Zenit-06” shpk me Nipt K61731002D, me seli në Tiranë, me administrator z. Rexhep Tarba,**

Procedura e prokurimit: **“Mbikqyrje e punimeve për zbatimin e kontratës me objekt “Projekti Asambli Rilindja Belsh”**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Realizimi i shërbimit të mbikqyrjes së punimeve për zbatimin e kontratës me objekt **“Projekti Asambli Rilindja Belsh”**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët x oferta ekonomike më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **“Gjeokonsult & Co” shpk me Nipt K91810005U**, me vlerë ofertë **2 374 166** (dymilion e treqind e shtatëdhjetë e katërmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekëpa tvsh

2. **“Rean” shpk me Nipt J61827043V** dhe **“A.SH.Engineering” shpk me Nipt L31617003F**, me vlerë ofertë **1 737 550** (njemilion e shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekëpa tvsh.

3. **“Zenit-06” shpk me Nipt K61731002D**, me vlerë ofertë **1 960 000** (njemilion e nentëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekëpa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **“Rean” shpk me Nipt J61827043V** dhe **“A.SH.Engineering” shpk me Nipt L31617003F**, me vlerë ofertë **1 737 550** (njemilion e shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekëpa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

*Operatori nuk ka arritur të paraqesë dokumentacionin e plotë dhe të saktë për të deshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim sic kerkohen në DT.*

Konkretisht:

Nuk eshte paraqitur kontrata e Bashkepunimit dhe prokura e posacme qe autorizon se kush do ta perfaqesoje kete bashkim operatoresh ne kete procedure prokurimi.

3. Bashkimi i operatoreve ekonomike “Elira”&BE-IS”shpk numri NIPT:J 63423410S

Me vlere te ofertes **8 933 516**(tete milion e nenteqinde e e tridhjetete e tre mije e peseqinde e gjashtembdhjete ) leke pa Tvsh

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:

1. **Skualifikohet operatori ekonomik “Shendelli” shpk.**per arsyet e meposhteme:

- Nuk ka dorezuar formularin e ofertes sipas shtojces 1 ,preventivin,grafikun e punimeve
- Nuk ka dorezuar shtojcat:Declaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;Declaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7; Formular vlerësimi sipas Shtojcës 8; Declaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9,Declaratë mbi Gjendjen Gjyqësore sipas shtojces 11
- Nuk jane dorezuar Listepagesat sipas formes qe kerkohe nga legjislacioni ne fuqi per te gjithë periudhen e kerkuar janar 2013 –qershor 2016, shoqeruar keto dhe me formularet e deklarimit te pagesave per sigurimet shoqerore e shendetesore (FDP) dhe TAP.

- Ne vertetimet e sigurimeve shoqerore te dorezuara numri i punonjesve te siguruar eshte me pak se 95 punonjes te kerkuar ne 2.3.4 te kriterëve te kualifikimit te DST
  - Nuk ka paraqitur dokumentacionin per stafin drejtues te kerkuar ne piken 2.3.5 te kriterëve te kualifikimit
  - Nuk disponon Linje per perpunim materialesh inerte te pajisur me QKL kerkuar ne piken 2.3.6 te kriterëve te kualifikimit
2. **Skualifikohet bashkimi i operatoreve ekonomik ELIRA” &“BEIS” shpk**.per arsyet e meposhteme:
- **“Elira” shpk:** Ne baze te kontrates se bashkepunimit date 22.08.2016 “Elira “ shpk merr persiper te kryeje 60 % te punimeve te objektit.Ne zbatim te nenit 74 /3 te VKM-se Nr.914 dt 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, “Kerkesat ekonomike,financiare,profesionale dhe ato teknike duhet te permbushen nga I gjithë bashkimi,ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne pune ,sherbim apo furnizim ,te percaktuara ne aktmarreveshje.Mbi bazen e dokumentacionit te dorezuar lidhur me numrin e punonjesve te siguruar dhe perqindjes se pjesemarrjes ne bashkim “Elira “shpk nuk ploteson numrin mesatar te punonjesve te siguruar ,60% te numrit total te kerkuar ne Kriteret e Kualifikimit.Mesatarja per 3 vitet 2014-2015,dhe janar qershor 2016 llogaritet nr.mesatar ,pra 38 punonjes ose 19 punetore me pak se perqindja.
  - Shtojca 9 e dorezuar ne sistem elektronik nga “Elira” shpk eshte plotesuar per tjetër autoritet kontraktor,tjetër object prokurimi dhe tjetër fond limit.Po ashtu per mjetet e pasqyruara ne shtojcen 9 nuk eshte sjelle dokumentacioni shoqerues i kerkuar ne kriteret e kualifikimit.Dokumentacioni shoqerues I dorezuar per mjetete tjera nuk eshte I plote sipas Kriterëve te kualifikimit , per shumicen e tyre mungon certifikata e transportit.
  - Per pune te ngjashme ‘Elira “shpk ka dorezuar ne system dy kontrata “ Ndertim I ures HD 6 m mbi lumin Vjose” dhe “Rikonstruksion I kanalit te furnizimit te rezervuarit te Gjancit – Korce” dhe per te dy keto kontrata nuk jane dorezuar faturat tatimore te kerkuara ne piken 2.3.1 te Kriterëve te kualifikimit
  - Dy drejtuesit teknike te perfshire ne licensen e “Elira “shpk Matilda Lleshi dhe Fehime Ahmeti (Karagjozi) nuk perfshihen ne listepagesat e muajit qershor 2016.
  - “Elira “ shpk nuk ka dorezuar liste pagesat e punonjesve per periudhen janar –dhjetor 2013 si dhe periudhen janar-dhjetor 2014 si dhe formularet e deklarimit (FDP dhe TAP) per kete periudhe
  - Per pune te ngjashme ‘Be-Is “shpk ka dorezuar ne system kontraten “ Ndertim rrjeti kanalizimeve ne zonen qe kufizohet nga rr.Teodor Keko ,lumi Lanes” dhe per kete kontrate nuk ka dorezuar faturat tatimore te kerkuara ne piken 2.3.1 te Kriterëve te kualifikimit si dhe aktin e marrjes ne dorezim te objektit.Po keshtu ne kontraten me object “Furnizim me uje i fshatit Tujan.....” mungon akti I marrjes ne dorezim
  - Me perjashtim te kamionit me targe AA753 LO ,AA 781 JV,ACR793,AA782 JV dhe ACR 793,dokumentat per mjetet e tjera te hedhura ne system nga BE-IS nuk jane perfshire ne deklaraten per disponimin e mjeteve shtojca 9.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se Operatori ekonomike **“Bajrami-N”**shpk ,me vlere te ofertes **14 402 290**(katermbedhete milion e katerqinde mije e dyqinde e

mentedhjete ) leke pa Tvsh,dhe **17 282 748**(shtatembedhjete milion e dyqinde e tetedhjete e dy mije shtateqinde e dyzete e tete)leke me Tvsh eshte shpallur si oferta me e sukseshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkise Gramsh,sheshi “Kamber Dermyshe” kopjen e nënshkruar të formularit të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do te perseritet tenderi ,siç parashikohet në nenin 49 të ligjit nr.9643, date 20.11.2007 “Për prokurimin publik”

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 30.08.2016.

Ankesa: Nuk ka patur ankesa

## **BASHKIA RROGOZHINE** **FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

**Data. 07.09.2016**

**Nga: Bashkia Rrogozhine**

Për: “*Company Riviera 2008“ sh.p.k me. Nipti: K81716011V, adresa: Rruga Nacionale Kamez-Fushe Kruje, Kthesa e Valiasit, Nr.1, Zk 2066, Nr. Pasurie 2066, Kamez ,Tirane.*

Procedura e prokurimit: **E hapur.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “*Rivitalizimi urban i qendres se qytetit, Rrogozhine*”.

Fondi limit per kete prokurim eshte: 124.997.358 (njqind e njezetekater milion e nenteqind e nentedhjete e shtate mije e treqind e pesedhjete e tete) leke pa T.v.sh.

**Burimi i te ardhurave : Buxheti i Shtetit.**

**Afati per kryerjen e punimeve 180 dite nga lidhja e kontrates.**

**Data e zhvillimit se procedures se prokurimit- 25.08.2016 ora 09.00.**

**Publikime të mëparshme (po): Buletini i Njoftimeve Publike nr.32 date [15.08.2016]**

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1. Oferta e shoqerise,” **Company Riviera 2008” shpk**, me nr. Nipti: **K81716011V**, me vlere te ofruar: **124.986.479** (njqind e njezet e kater milion e nente qind e tetedhjete e gjashte mije e katerqind e shtatedhjete e nente) leke pa tvsh.

**Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:**

Perkatesisht per arsyet e meposhtme: **Nuk ka ofertues te skualifikuar.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *operatorin ekonomik*, “*Company Riviera 2008*“ *sh.p.k me*. Nipti: *K81716011V*, *adresa: Rruga Nacionale Kamez-Fushe Kruje, Kthesa e Valiasit, Nr.1, Zk 2066, Nr. Pasurie 2066, Kamez, Tirane*, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **124.986.479 (njqind e njezet e kater milion e nente qind e tetedhjetë e gjashtë mijë e katerqind e shtatedhjetë e nente) leke pa tvsh**, është *identifikuar si oferta e suksesshme, rrjedhimisht jeni te lutur te paraqisni prane, Adresa: Bashkia Rrogozhine, Lagjia Nr.1, Rruga Kavajes*, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej: [], siç parashikohet në nenin 58, të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, te ndryshuar.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 30.08.2016**

**Ankesa: Nuk ka.**

**BASHKIA KORCE**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

*Date 07.09.2016*

*Nga: Bashkia Korce, rruga “28 Nentori”, 082 243353.*

*Për: Shoqeria “G.P.G Company” sh.p.k, adresa: Fier, Lushnje, Lagj.18, godine 1 kateshe, si perfaqesuese e bashkimit te operatoreve “G.P.G Company” sh.p.k & AD-STAR sh.p.k.*

\* \* \*

Procedura e prokurimit: *Procedure e hapur*

Objekti: **“Rikonstruksion i qendres dhe infrastruktures rrugore dhe monumenteve te Kultures Voskopoje”**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *Kjo kontrate ka per qellim rikonstruksionin e qendres dhe infrastruktures rrugore, si dhe restaurimin e monumenteve te kultures ne fshatin turistik Voskopoje*

Fondi limit: **308.333.332 lek**

Burimi i financimit: *Buxheti i shtetit*  
**Investim**

Data e zhvillimit te procedures se prokurimit: **01.08.2016**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri] -

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: *çmimi më i ulët*

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

**1. Bashkimi i shoqerive G.P.G. COMPANY sh.p.k NIPT J64324443V dhe AD-STAR sh.p.k NIPT J69102207W me vlere:**

**302.486.104 (treqind e dy milion e katerqind e tetedhete e gjashte mije e njeqind e kater)lek,pa tvsh.**

**2. Shoqeria “SHENDELLI”sh.p.k**

*Nuk ka paraqitur oferte ekonomike*

**3. Shoqeria “ELEKTRO THERM”sh.p.k**

*Nuk ka paraqitur oferte ekonomike*

**4. Subjekti “LUMAN BIBA”**

*Nuk ka paraqitur oferte ekonomike*

\* \* \*

Jane s’kualifikuar ofertuesit e meposhtem:

**1. Shoqeria “SHENDELLI”sh.p.k, per arsye se:**

Shoqeria “Shendelli” sh.p.k ka paraqitur vetem nje ekstrakt historik te regjistrit tregetar dhe nuk ka paraqitur oferte ekonomike.

Per sa me siper komisioni ne menyre unanime arriti ne perfundimin se kjo shoqeri nuk ka paraqitur te gjithë dokumentat ligjore, administrative, kualifikuese të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

**2. Shoqeria “ELEKTRO THERM”sh.p.k, per arsye se:**

Shoqeria “Elektro Therm” sh.p.k ka paraqitur vetem nje ekstrakt te regjistrit tregetar dhe nuk ka paraqitur oferte ekonomike.

Per sa me siper komisioni ne menyre unanime arriti ne perfundimin se kjo shoqeri nuk ka paraqitur te gjithë dokumentat ligjore, administrative, kualifikuese të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

**3. Subjekti “LUMAN BIBA”sh.p.k, per arsye se:**

Subjekti Luman Biba nuk ka paraqitur asnje dokument

Per sa me siper komisioni ne menyre unanime arriti ne perfundimin se kjo shoqeri nuk ka paraqitur te dokumentat ligjore, administrative, kualifikuese të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

\* \* \*



Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Shoqerine “G.P.G Company”sh.p.k si perfaqesuese e bashkimit te operatoreve G.P.G Company sh.p.k & Ad- Star sh.p.k**, se oferta e paraqitur me një vlerë prej **302.486.104(treqind e dy milion e katerqind e tetedhete e gjashte mije e njeqind e kater)lek pa tvsh**, është identifikuar si oferta e suksesëshme

Rrjedhimisht, jeni te lutur të paraqisni pranë **Bashkise Korçë** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të së këtij njoftimi, por jo me vonë se 5 dite nga kërkesa e per lidhjen e kontrates.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: **30.08.2016**

Ankesa: **Nuk ka**

## **BASHKIA ROSKOVEC** **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data **07.09.2016**]

Për: **[BOSHNJAKU.B SHPK]**

Procedura e prokurimit: **“Kerkese per propozim”**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"NDERTIM RRETHRROTULLIMI NE ANEN LINDORE NE UNAZEN ROSKOVEC"**.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike **[8 GUSHT 2016] [31]**  
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **PO** oferta  ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- |  |                                      |
|--|--------------------------------------|
| 1. <b><u>“PESE VELLEZERIT” shpk</u></b><br>Emri i plotë i shoqërisë<br>Vlera <b><u>6 384 567</u></b> (gjashtemilion e pesëqindgjashtedhjeteshtate) <b>leke pa tvsh</b> (me numra dhe fjalë)                          | <b>L22925402C</b><br>numri i NIPT-it |
| 2- <b><u>“BOSHNJAKU. B” shpk</u></b><br>Emri i plotë i shoqërisë<br>Vlera <b><u>7 396 955</u></b> (shtatemilion e treqindenentedhjetegjashtemije e nenteqindepsedhjetepese) <b>leke pa tvsh</b> (me numra dhe fjalë) | <b>K72627402H</b><br>numri i NIPT-it |

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- 1) **“PESE VELLEZERIT” shpk**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Nuk ka paraqitur:

1. *Licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:*
  - *N.P – 6 A Diga dhe tunele hidroteknike.*
  - *N.P – 8 A Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë.*
  - *N.P – 10 A Ndërtim i impianteve për prodhimin e energjise elektrike*
2. *Certifikatën ISO:*
  - *ISO SA 8000:2014 e vlefshme,*
  - *ISO BS EN 13331-1:2002 e vlefshme,*
  - *ISO DS CEN/TR 15128:2005 e vlefshme,*
  - *ISO 50001:2011 e vlefshme,*
  - *ISO/IEC 27001:2013 e vlefshme,*
  - *EN – ISO 3834-2:2006 e vlefshme.*
3. *Fabrika për prodhimin e betonit, Fabrika për prodhimin e inerteve ose kontratë furnizimi me prodhues sipas kërkesave ne DST.*
4. *Punonjës të siguruar minimumi 70 (shtatedhete) punonjës për periudhën Gusht 2014 - Qeshor 2016, për të vërtetuar këtë ofertuesi të paraqesë vërtetim nga organet tatimore. Ofertuesi të paraqesë listëpagesat te konfirmuara nga administrata tatimore perkatese me nenshkrim dhe vule për periudhën Janar 2015 - Qeshor 2016.*
5. *Mjekë, 1 të punësuar, i cili te jete i pasqyruar ne listepagesat e shoqerise per periudhen prill – qeshor 2016, referuar VKM Nr.742, datë 6.11.2003 "Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë" të vertetuar me kontratë noteriale pune, diplomë dhe licensë.*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [ **“BOSHNJAKU.B " shpk , Fier “**] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **7 396 955** (shtatemilion e treqindenedhjetegjashtemije e nenteqindpsedhjetepese) leke pa tvsh pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [BASHKIA ROSKOVEC - Drejtoria Juridike] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, **brenda 60 (gjashtedhete) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **28.08.2016**

Ankesa: ka ose jo **JO**

(nëse ka) ka marrë përgjigje në date

**“POSTA SHQIPTARE” SH.A.**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

**Data 08.09.2016**

**Nga:** Autoriteti Kontraktor “Posta Shqiptare” sh.a.,  
**Adr.:** Terminal Center, Kthesa e Kamzës, Tiranë

**Për:** Operatorit “ADEL CO” sh.p.k. NIPT L22117021M  
**Adr:** Rr. “Muhamet Gjollësja”, “Zogu i Zi”, Tiranë

\* \* \*

**Procedura e prokurimit:** Referuar Urdherit te Prokurimit Nr. 20, datë 27.04.2016 me objekt: “Blerje Shtypshkrime për vitin 2016”, me fond limit **41.163.310 (dyzet e një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e dhjetë) Lekë**, me procedurë ”Të hapur”, në formë elektronike, që u zhvillua me datë **12.07.2016, ora 10.00** [Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor]

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Blerje Shtypshkrime për vitin 2016, me kohezgjatje kontrate, **90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarik nga hyrja në fuqi e kontratës.**

**Fondi Limit:** **41.163.310 (dyzet e një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e dhjetë) Lekë**

**Burimi i financimit:** Financuar nga te ardhurat e shoqerise Posta Shqiptare sh.a.

**Data e zhvillimit të procedures së prokurimit:** **12.07.2016**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *Date [Numri ]*

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë keta ofertues me ofertat ekonomike si vijon:

1. Operatori “**Adel CO**” sh.p.k. NIPT L22117021M me vlerë të ofertës **38.537.795,4** (tridhjetë e tete milion e peseqind e tridhjet e shtate mije e shtateqind e nentedhjet e pese presje kater) Lekë.
2. Operatori “**Albdesign PSP**” sh.p.k. NIPT L51819005Q me vlerë të ofertës **39.428.649** (tridhjet e nente milion katerqind e njezet e tete mije e gjashteqind e dyzet e nente) Lekë.
3. Operatori “**Kristalina KH**” sh.p.k. NIPT K11501002D me vlerë të ofertës **34.547.100** (tridhjet e kater milion e peseqind e dyzet e shtate mije e njeqind) Lekë.
4. Operatori “**Expo Sistem**” sh.p.k. ska dokumentacion
5. Operatori “**Graphik Line 01**” sh.p.k. ska dokumentacion
6. Operatori ”**Maluka**” sh.p.k. ska dokumentacion.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtem:

Operatori “**Albdesign PSP**” sh.p.k.; Operatori “**Kristalina KH**” sh.p.k.; Operatori “**Expo Sistem**” sh.p.k.; Operatori “**Graphik Line 01**” sh.p.k. ”**Maluka**” sh.p.k.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

**Operatori “Albdesign PSP” sh.p.k. është s’kualifikuar pasi:**

a) Nuk përmbushet pika 2.1.1 e kriterëve të veçanta për kualifikim **Kapaciteti ekonomik dhe financiar**: pasi vërtetim për xhiron mesatare vjetore 201 - 2014 – 2015, e cila duhet të jete sa vlera limit e kontrates që prokurohet ndërkohë që operatori ka paraqitur xhiro vetëm për 2015 dhe jo sipas kriterit të përcaktuar.

b) Nuk përmbushet pika 2.1.2 e kriterëve të veçanta për kualifikim **Kapaciteti ekonomik dhe financiar**: pasi mungojnë Bilancet e viteve 2013, 2014 te paraqitura prane autoriteteve perkatese.

Nuk plotësohet pika 2.2.2 e kriterëve të vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, i Shtojcës 8, pasi ka paraqitur vërtetim për përmbushjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore për fuqi puntore prej jo më pak se 20 punonjës për periudhën Korrik-Dhjetor 2015 dhe jo sipas kerkesave te DST-ve ku operatori ekonomik ofertues duhet te paraqes vërtetim për përmbushjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore për fuqi puntore prej jo më pak se 20 punonjës për periudhën Janar-Dhjetor 2015.

**Operatori “Kristalina KH” sh.p.k. është s’kualifikuar pasi:**

a) Nuk plotësohet pika 2.3.3 e kriterëve të vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, **pasi nuk ka paraqitur faturë tatimore ose dokument** zhdoganimi se disponon dhe makineri CTP por ka paraqitur nje kontrate qeraje ku merr me qera kete pajisje nga ku rezuton sipas dokumentacionit te dorezuar nga OE se edhe qeradhenesi nuk eshte pronar dhe nuk ka te drejte ta jape me qera nje te treti sipas kontrates nr.4164 rep date 29.03.2012. Pra dokumentacioni i dorezuar nuk eshte i rregullt dhe nuk permbush kriterin 2.3.3.

b) Nuk plotësohet pika 2.3.5 e kriterëve të vecanta ”Operatori Ekonomik duhet të ketë ambjent të përshtatshëm për magazinimin produkte letre me sipërfaqe jo më pak se 200 (dyqind) meter katror, të vërtetuar me dokument pronësie ose kontrate qeraje” pasi OE ka paraqitur nje kontrate qeraje ku merr me qera nje truall me sipërfaqe 200 m2 nderkohe qe ne dst eshte kerkuar ambient i pershtatshem .

Nuk plotësohet pika 2.3.7 e DST-ve ”Operatori ekonomik, referuar numrave të modeleve të përcaktuara në Shtojca 12, Sasia dhe grafiku i lëvrimit,

- Operatori “Expo Sistem” sh.p.k. ska dokumentacion
- Operatori “Graphik Line 01” sh.p.k. ska dokumentacion
- Operatori ”Maluka” sh.p.k. ska dokumentacion.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin “ADEL CO” sh.p.k. NIPT L22117021M Adr: Rr. “Muhamet Gjollështa”, “Zogu i Zi”, Tiranë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me vlerë 38.537.795,4 (tridhjetë e tete milion e pesëqind e tridhjet e shtate mije e shtateqind e nentedhjet e pesë presje katër) Lekë, [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Posta Shqiptare Sh.a. Terminal Center, Kthesa e Kamzes, Tiranë, Drejtoria Juridike, kati III [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do të anulohet, siç parashikohet në nenet 24 dhe 58 të ligjit për prokurimet publike Nr. 9643 datë 20.11.2006 (me ndryshimet).

Është bërë njoftimi i klasifikimit të ofertave me datë **26.07.2016**.

Ankesa: ka ose jo: Brenda afateve të parashikuara nga ligji, kemi patur ankesa nga operatorët **“Kristalina KH” Sh.p.k. dhe “Albdesign PSP” sh.p.k.**

Konform ligjit janë trajtuar ankesat dhe u është kthyer përgjigje operatorëve ankimues. Operatorët ankimues **“Kristalina KH” Sh.p.k. dhe “Albdesign PSP” sh.p.k.** duke mos u pajtuar me përgjigjen e autoritetit kontraktor kanë paraqitur ankesa pranë KPP\_së.

Në përfundim të hetimit administrativ të procedurës lidhur me ankesat e paraqitura, **Komisioni i Prokurimit Publik me Vendimin Nr. 682/2016 datë 02.09.2016** ka vendosur **të mos pranohen ankesat** e paraqitura nga operatorët ankimues **“Kristalina KH” Sh.p.k. dhe “Albdesign PSP” sh.p.k.** duke lejuar autoritetin kontraktor për vazhdimin e hapave të mëtejshem të procedurës së prokurimit.

### **SPITALI RAJONAL FIER** **FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

Për: **“Alstezo”**, shpk Fier, “Lagja Kryengritja e Fierit”, Fier.

Procedura e prokurimit: **“Tender Kerkese per Propozim”**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Riparimi dhe Mirembajtja e Automjeteve per nevoja te Spitali Rajonal Fier”** me fond limit : **1 081 300** ( nje milion e tetedhjete e nje mije e treqind ) leke pa TVSH.

Kohezgjatja nga data e lidhjes se kontrates deri me date **31.12.2016**.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): **Buletini i Njoftimeve Publike nr.28** date 18 Korrik 2016

Kriteret e perzgjedhjes se fituesit : **Cmimi me i ulet**

Burimi i financimit: **Te ardhurat Dytesore .**

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **30.08.2016**

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne kete procedure ofertuesit e meposhtem me vlera perkatese te ofruara :

1. **“Alstezo”** shpk Fier

**NIPT J63208420N**

Vlera : 1 073 000 ( nje milion e shtatedhete e tre mije) pa TVSH dhe 1 287 600 (nje milion e dyqind e tetedhete e shtate mije e gjashteqind) leke me TVSH

**Jane skualifikuar ofertuesi i meposhtem:**

**NUK KA**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “Alstezo” shpk Fier se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **1 073 000** ( nje milion e shtatedhete e tre mije) **pa** TVSH dhe **1 287 600** (nje milion e dyqind e tetedhete e shtate mije e gjashteqind) leke **me** TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorise se Spitalit Rajonal Fier me adrese L. 1 Maji rruga “Invalidet e Luftes” kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjete) ditëve nga dita e marrjes/publikimit së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kjo procedure prokurimi do te anulohet , siç parashikohet në nenin 24 të ligjit nr.9643 date 20.11.2006 “Për prokurimin publik i ndryshuar

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 30.08.2016

**Ankesa:** Ka patur ankese ne KPP lidhur me kriteret e DST dhe ju eshte kthyer pergjigje nga KPP me vendimin nr. 636/1, date 22.08.2016 administruar nga Autoriteti Kontraktor me nr.2226, date 24.08.2016.

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË**  
**PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

**Data 07.09.2016**

Nga: **Inspektorati i Larte i Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesave.**

Per: **Shoqerine ATOM Sh.p.k me adrese: Njesia bashkiake nr 10, Rr Islam Alla, Tirane.**

\* \* \*

Procedura e prokurimit: **Blerje paisje kompjuterike dhe elektronike.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Blerje paisje kompjuterike dhe elektronike për Inspektoratin e Larte te Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesave.**

Fondi Limit: **945.000 leke pa Tvsh.**

Burimi i financimit: **Buxheti i shtetit.**

Data e zhvillimit te procedures: **29.08.2016.**

Publikime te meparshme, **Buletini i Njoftimeve Publike Nr 33, Date 22 Gusht 2016.**

Njoftojme se kane qene pjesemares ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

|  |                        |
|--|------------------------|
| <b>1. Shoqeria Fastech Sh.p.k</b><br>Oferta <b>764.400 leke</b> (pa TVSH).         | <b>NIPT J81609010U</b> |
| <b>2. Shoqeria PC Store Sh.p.k</b><br>Oferta <b>782.700 leke</b> (pa TVSH).        | <b>NIPT L01606034A</b> |
| <b>3. Shoqeria Atom Sh.p.k</b><br>Oferta <b>849.600 leke</b> (pa TVSH).            | <b>NIPT L22203042N</b> |
| <b>4. Shoqeria Addon Sh,p,k</b><br>Oferta <b>900.900 leke</b> (pa TVSH).           | <b>NIPT L32014007G</b> |
| <b>5. Shoqeria BNT Electronics Sh.p.k</b><br>Oferta <b>919.868 leke</b> (pa TVSH). | <b>NIPT J61817047D</b> |
| <b>6. Shoqeria Euro Inform Sh.p.k</b><br>Nuk paraqiti oferte                       | <b>NIPT J33721008C</b> |

\* \* \*

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:

**Operatori FASTECH SH.P.K** skualifikohet pasi:

- Nuk plotëson specifikimet teknike si me poshtë:

#### **Kompjuter desktop**

|   |      |
|---|------|
| Pikët min. për procesorin sipas: cpu benchmark.net Min Proc. Rating according to: cpubenchmark.net: | 5400 |
|---|------|

#### **Printer B&W**

|                   |         |
|-------------------|---------|
| Memorja “ Memory” | ≥256 MB |
|-------------------|---------|

**Operatori PC Store Sh.p.k** skualifikohet pasi:

- Nuk plotëson specifikimet teknike si me poshtë:

**Kompjuter desktop**

|   |      |
|---|------|
| Pikët min. për procesorin sipas: cpu benchmark.net Min Proc. Rating according to: cpubenchmark.net: | 5400 |
|---|------|

**Printer B&W**

|                  |         |
|------------------|---------|
| Memorja “Memory” | ≥256 MB |
|------------------|---------|

**Switch i menaxhueshem**

|                  |  |
|------------------|--|
| Management Port  | : 1 x RJ45 Serial Port, Ethernet In/Out Band |
| Layer 2 Features | : TACACS+                                    |
| Layer 3 Routing  | : Static Routing                             |
|                  | : Policy Based Routing                       |
| Management       | : CLI  |
|                  | : SSH  |
|                  | : Telnet                                     |

**Operatori BNT Electronics Sh.p.k** skualifikohet pasi:

- Nuk plotëson specifikimet teknike si me poshtë:

**Kompjuter desktop**

|   |      |
|---|------|
| Pikët min. për procesorin sipas: cpu benchmark.net Min Proc. Rating according to: cpubenchmark.net: | 5400 |
|---|------|

**Operatori Addon Sh.p.k** skualifikohet pasi :

- a) ne oferten e paraqitur nuk jane perfshire modelet e produkteve dhe specifikimet perkatese te tyre:
- b) Operatori Addon sh.p.k nuk paraqiti kontrate ku te kishte realizuar furnizime me objekt te ngjashtem me objektin e prokurimit.

**Operatori Euro Inform Sh.p.k** skualifikohet pasi ne dosjen elektronike te dorezuar nuk u gjeten dokumenta.



Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Shoqerine ATOM Sh.p.k me adrese: Njesia bashkiake nr 10, Rr Islam Alla, Tiranë**, se oferta e paraqitur, me vlere 849.600 ( teteqind e dyzet e nentemije e gjashteqind) leke pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Inspektoratit te Larte te Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesave** kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës procedura do te anulohet bazuar ne ligjin për prokurimet publike nr.9643 date 20.11.2006

\* \* \*

Njoftimi i klasifikimit eshte bere ne date **30.08.2016**.

Ankesa ka ose jo. **Nuk ka patur asnje ankese**

### **AKADEMIA E SHKENCAVE** **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Për: Operatorin ekonomik “ADEL CO“ sh. p.k.  
Adresa: Rruga “Muhamet Gjollesha”, Zogu i Zi, Tiranë.

Procedura e prokurimit: E hapur

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Shtypshkrime libri dhe periodike”

Kohëzgjatja e kontratës deri më 31.12.2016.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

\* \* \*

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- |  |            |
|--|------------|
| 1. ADEL-CO Shpk  | L22117021M |
| Vlera: 4.161.300 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetënjë mijë e treqind)Lekë pa TVSH.                   |            |
| 2. ALBDESIGN Shpk  | L51819005Q |
| Vlera: 6.799.850 (gjashtë milion e shtatëqind e nëntëdhjetënjë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH. |            |
| 3. DAJTI 2000 Shpk   | K01408001D |
| Vlera: 4.137.940 (katër milion e njëqindtridhjetëeshtatë mijë e nëntëqindedyzet) Lekë pa TVSH.             |            |
| 4. ILAR Shpk   | J62027009T |
| Vlera: 6.230.000 (gjashtë milion e dyqind e tridhjetë mijë) Lekë pa TVSH.                                  |            |
| 5. KRISTALINA-KH Shpk  | K11501002D |
| Vlera: 4.269.000 (katër milion e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë) Lekë pa TVSH.                        |            |
| 6. MALUKA sh.p.k.  | J71424009P |
| Vlera: nuk ka paraqitur ofertë.  |            |
| 7. MORAVA sh.p.k.  | J82019001J |
| Vlera: 5.313.500 (pesë milion e treqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH.                      |            |

8. ONUFRI Shpk  
Vlera: nuk ka paraqitur ofertë.

J91801003E

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

|                      |            |
|----------------------|------------|
| 1. "MALUKA" shpk     | J71424009P |
| 2. "DAJTI 2000" shpk | K01408001D |
| 3. "ONUFRI" Shpk     | J91801003E |

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Dajti 2000 sh.p.k.:
- 1. ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në pikën 1 të kritereve të përgjithshme për kualifikim, por rezulton se ekstrakti historik i QKR-së është i lëshuar nga sistemi në datë 03.03.2016, pra më parë se 3 muajt e lejuar sipas DST-së. Gjithashtu KVO vëren se ofertuesi nuk ka dorëzuar Deklaratën për gjendjen gjyqësore, sipas Shtojcës 9 të kërkuar në DST, por ka dorëzuar një vërtetim penal për të vërtetuar gjendjen e tij. Gjithashtu vërehet se është dorëzuar më tepër dokumente të pakërkuar në DST:
- Sigurim oferte datë 23.0.2016 drejtuar Drejtorisë së Policisë së Shtetit;
- Pasqyrat financiare për vitin 2012; 2013;2014.
- 2. Ofertuesi ka paraqitur dokument nga Autoritetet tatimore të datës 04.03.2016, pra të më parë se tre muaj, sic kërkohet në DST, dokument i cili vërteton që subjekti ka paguar detyrimet fiskale dhe ato të sigurimeve shëndetësore deri më datën 29.02.2016. Gjithashtu ky dokument nuk është origjinal.
- 3. Ofertuesi ka dorëzuar Ekstraktin e QKL-së me datë 03.3.2016, pra më parë se tre muajt e lejuar në DST.
- 4. Ofertuesi nuk ka përmbushur kushtin për shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike pasi vërtetimi i paraqitur nga OSHEE është i datës 25.03.2016, ku deklarohet që nuk ka detyrime, por nuk përfshihet muaji shkurt. Sipas pikës 2.1.d. të DST/Kriteret e Veçanta, duhet të dorëzohet një dokument që vërteton pagesën e detyrimeve të energjisë së maturuara, deri në datën e hapjes së tenderit (06.06.2016) janë maturuar edhe detyrimet e muajit shkurt, mars dhe prill që nuk vërtetohen si ta paguara.
- 5. Ofertuesi ka dorëzuar ISO, e vlefshme deri në 2016, por është jo-origjinale, jo e përkthyer dhe jo e noterizuar.
- 6. Ofertuesi për të vërtetuar sipas kërkesës së pikës 2.3.2 të Kritereve të Veçanta që ka të punësuar minimalisht 10 punonjë, ka dorëzuar vetëm vërtetimet por jo listëpagesat për janar-dhjetor 2015 dhe janar-mars 2016, siç është kërkuar.
- 7. Ofertuesi në formularin e ofertës ka bërë një gabim në përllogaritje, përse i përket artikullit të renditur në nr. 18 "Studia albanaica" nr. 1/2016, në specifikimet teknike është kërkuar 200 kopje, ndërsa në formularin e ofertës rezulton 172 kopje (në fakt është nr. i faqeve të librit). KVO bëri përllogaritjen e saktë, sipas së cilës oferta totale duhet të ishte 4.149.700 lekë pa TVSH, pra gabimi është në vlerën 11.760 lekë.
- 8. Ofertuesi nuk ka paraqitur mostrën në datën orën dhe formën e kërkuar sipas pikës 2.3.4 të KVK të DST.

9. Ofertuesi nuk ka përmbushur kushtin e përcaktuar në pikën 2.3.5 të DST/Kriteret e Veçanta pasi nuk ka dorëzuar deklaratën për pajisjen me makineritë, deklaratën për cilësinë e letrës dhe mungojnë dokumentet për të vërtetuar pajisjen me makinat e kërkuara, rezulton vetëm një dokument zhdoganimi për një makineri me 4C, por pa përcaktuar përmasat, si dhe një makineri offset bardhezi 70x100.

- "Maluka" shpk

1. nuk ka paraqitur ofertë, por ka paraqitur si dokumenta vetëm ekstraktin e QKR.

- "Onufri" shpk nuk ka paraqitur:

1. Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve sipas shtojcës 6;
2. Deklaratë mbi konfliktin e interesit sipas Shtojcës 7;
3. Formularin e ofertës;
4. Vërtetimin mbi shlyerjen e detyrimeve të energjisë;
5. Vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron;
6. Kopje të bilancit të vitit 2015;
7. për të vërtetuar punësimin e punonjësve nuk ka dorëzuar listëpagesat dhe vërtetimin për vitin 2015 dhe listëpagesat për vitin 2016;
8. Dëshmi për furnizime të ngjashme;
9. Mostrën e kërkuar;
10. Vërtetimet mbi disponimin e makinerive të kërkuara

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik "ADEL CO" sh. p.k. Rruga "Muhamet Gjollështa", Zogu i Zi, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **4.161.300 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e treqind) Lekë pa TVSH** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **AKADEMIA E SHKENCAVE Sheshi "Fan Noli" nr. 7 - Tiranë, Albania, Tel/Fax: +355 4 222 7476 Tiranë** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda **5 (pesë)** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 4.269.000 (katër milion e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë) Lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 30.08.2016

Ankesa: **ka** ose jo

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë 24.06.2016; 27.06.2016; 06.07.2016; Vendim i KPP-së datë 15.08.2016.

**MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE**  
**ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Data: 08.09.2016

Për: **Bashkimin e Përkohshëm të Operatorëve Ekonomikë “T&C” shpk, NIPT K92326018D, adresa Rruga Nacionale Fushë-Krujë-Vorë, Km1, ZK nr.1934, Nr. Pasurie 34/34, Fushë-Krujë, Durrës & “COMAR Commerciale S.p.a”, NIPT IT01115450429, adresa Senigallia (Ancona) Itali.**

\* \* \*

Procedura e prokurimit: E Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar me mjete elektronike

Përshkrim i shkurtër i kontratës:

1. Fondi limit 721 305 000 (shtatëqind e njëzet e një milion e treqind e pesë mijë) lekë pa TVSH
2. Burimi i Financimit : Buxheti i Shtetit për vitin 2016
3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër “Blerje eskavator me zinxhir për Bashkitë”: Loti i I-rë “Blerje eskavator me zinxhir, tip i mesëm”

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.18, date 09.05.2016

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X**

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **Operatori ekonomik “EUROGJICI SECURITY” shpk**  
**Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike**
2. **Operatori ekonomik “INTERNATIONAL” d.o.o & HERING d.d**  
Vlera **560 113 554** (pesëqind e gjashtëdhjetë milion e njëqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.
3. **Operatori ekonomik “KONSTRUTTIVA” S.C.P.A**  
**Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike**
4. **Bashkimi i Përkohshëm i operatorëve ekonomike “LAGER BASIC” d.o.o & “PODUZECE ZA CESTE d.oo”**  
Vlera **463 023 621.06** (katërqind e gjashtëdhjetë e tre milion e njëzet e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e njëpikëzerogjashtë) lekë pa TVSH.
5. **Operatori ekonomik Luman Biba**  
**Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike**

6. **Bashkimi i Përkohshëm i operatorëve ekonomike “START CO” shpk & “MB KURTI” shpk**  
Vlera **609 024 000** (gjashtëqind e nëntë milion e njëzet e katër mijë) lekë pa TVSH.
7. **Bashkimi i Përkohshëm i operatorëve ekonomike “TEKNOXGROUP SHQIPERI” shpk & “TEKNOXGROUP SLOVENIJA” d.o.o**  
Vlera **596 693 370** (pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e treqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.
8. **Operatori ekonomik “LAGER d.oo Posusje”**  
Vlera **594 209 525.91** (pesëqind e nëntëdhjetë e katër milion e dyqind e nëntë mijë e pesëqind e njëzet e pesëpikë nëntëdhjetë enjë) lekë pa TVSH.
9. **Bashkimi i Përkohshëm i operatorëve ekonomike “T & C” shpk & “COMAR COMERCIALE” S.P.A**  
Vlera **531 281 751** (pesëqind e tridhjetë e një milion e dyqind e tetëdhjetë e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **Operatori ekonomik “EUROGJICI SECURITY” shpk**  
**Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike**
2. **Operatori ekonomik “KONSTRUTTIVA” S.C.P.A**  
**Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike**
3. **Bashkimi i Përkohshëm i operatorëve ekonomike “LAGER BASIC” d.o.o & “PODUZECE ZA CESTE d.oo”**  
Vlera **463 023 621.06** (katërqind e gjashtëdhjetë e tre milion e njëzet e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e njëpikëgjashtë) lekë pa TVSH.
4. **Operatori ekonomik Luman Biba**  
**Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- I. **Bashkimi i Përkohshëm i operatorëve ekonomike “LAGER BASIC” d.o.o & “PODUZECE ZA CESTE d.oo”** është skualifikuar në këtë procedurë prokurimi për arsye se ka dorëzuar formularin e sigurimit të ofertës të lëshuar nga një Kompani Sigurimi dhe jo nga një bankë ashtu sic është kërkuar në dokumentat e tenderit, si dhe ka ndryshuar përmbajtjen e Shtojcës 4 “Formulari i sigurimit të ofertës” duke dorëzuar një “Formular” me përmbajtje të ndryshme nga ajo e përcaktuar në dokumentat e tenderit për këtë procedurë, duke shtuar rastin e mospërmbushjes së një kushti **Ofertuesi ka dorëzuar një ofertë të papërgjegjshme**. Kjo bie në kundërshtim me Kreun II “UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË”, Seksioni 1 “Hartimi i ofertës”, pika 1.1 të dokumentave të procedurës së prokurimit në të cilën parashikohet se “*Operatorët ekonomikë*

janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme..”

**II. Operatori ekonomik “KOSTRUTTIVA S.C.P.A”** është skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi për arsye se nuk plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, pasi ky operator ekonomik në këtë procedurë prokurimi ka paraqitur vetëm ekstraktin e Regjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

**III. Operatori ekonomik “EUROGJICI SECURITY“ shpk** është skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi për arsye se nuk plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, pasi për këtë procedurë ka paraqitur Ekstrakt të regjistrimit tregtar dhe historikun e shoqërisë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit si dhe Vertetim nga tatimet, i cili vërteton që subjekti “Eurogjici Security“ shpk nuk ka detyrime. Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

**IV. Operatori ekonomik Luman Biba** është skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi për arsye se nuk plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument dhe nuk ka paraqitur ofertë ekonomike për këtë procedurë prokurimi.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Përkohshëm të Operatorëve Ekonomikë “T&C” shpk, NIPT K92326018D, adresa Rruga Nationale Fushë-Krujë-Vorë, Km1, ZK nr.1934, Nr. Pasurie 34/34, Fushë-Krujë, Durrës & “COMAR Commerciale S.p.a”, NIPT IT01115450429, adresa Senigallia (Ancona) Itali, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 531 281 751 (pesëqind e tridhjetë e një milion e dyqind e tetëdhjetë e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor (Bashkite, sipas shtojcës 12 në DT) sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, për të lidhur kontratën menjëherë pas publikimit të njoftimit të fituesit.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **560 113 554 (pesëqind e gjashtëdhjetë milion e njëqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH**, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 31.08.2016

Ankesa:

Me date 21.07.2016, në Ministri, është depozituar ankesa me numër hyrës 5714 Prot. nga Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomike “T & C” shpk & “COMAR COMERCIALE” S.P.A, për vlerësimin e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje eskavator me zinxhir për bashkitë”, Loti I “Blerje eskavator me zinxhirë, Tip i mesëm”. Pas shqyrtimit dhe një analize të

pretendimeve të ngritura në ankim Autoriteti Kontraktor vendosi të mos e marrë parasysh ankesën e Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve Ekonomike “T & C” shpk & “COMAR COMERCIALE” S.P.A për rivlerësim të ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje eskavator me zinxhir për bashkitë”, Loti I “Blerje eskavator me zinxhirë tip i mesëm”. Këtij ankimi ju kthye përgjigjë më datë 26.07.2016, përgjigje e cila u kontestuar në Komisionin e Prokurimit Publik nga ankuesi.

Komisioni i Prokurimit Publik pas shqyrtimit të këtij ankimi me Vendimin nr.643, datë 25.08.2016 ka vendosur :

1. Të pranojë ankesën e Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve Ekonomike “T & C” shpk & “COMAR COMERCIALE” S.P.A, për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje eskavator me zinxhir për Bashkitë”: Loti i I-rë “Blerje eskavator me zinxhir, tip i mesëm”, procedurë e zhvilluar më datë 27.06.2016 nga AK Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.
2. Të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve Ekonomikë Lager Basic” doo & “Pduzece Za Ceste” doo për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje eskavator me zinxhir për Bashkitë”: Loti i I-rë “Blerje eskavator me zinxhir, tip i mesëm” dhe të korrigjojë shkeljet, duke e skualifikuar këtë bashkim operatorësh ekonomik.

Pas njoftimit të këtij vendimi nga Autoriteti Kontraktor u procedua me rivlerësim të ofertave për këtë procedurë prokurimi në zbatim të vendimit të KPP-së.

**MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE**  
**ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Data: 08.09.2016

Për: **Bashkimin e Përkohshëm të Operatorëve Ekonomikë “T&C” shpk, NIPT K92326018D, adresa Rruga Nazionale Fushë-Krujë-Vorë, Km1, ZK nr.1934, Nr. Pasurie 34/34, Fushë-Krujë, Durrës & “COMAR Commerciale S.p.a”, NIPT IT01115450429, adresa Senigallia (Ancona) Itali.**

\* \* \*

Procedura e prokurimit: E Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar me mjete elektronike

Përshkrim i shkurtër i kontratës:

1. Fondi limit 210 980 000 (dyqind e dhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH
2. Burimi i Financimit : Buxheti i Shtetit për vitin 2016
3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër “Blerje eskavator me zinxhir për Bashkitë”: Loti i II-të “Blerje eskavator me zinxhir, tip i vogël”

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.18, date 09.05.2016

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X**

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1. Operatori ekonomik “EUROGJICI SECURITY” shpk**  
**Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike**
- 2. Operatori ekonomik “INTERNATIONAL” d.o.o & HERING d.d**  
Vlera **168 787 720.64** (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e njëzetpikëgjashtëdhjetëkatër) lekë pa TVSH.
- 3. Operatori ekonomik “ALMETA” GMBH**  
**Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike**
- 4. Bashkimi i Përkohshëm i operatorëve ekonomike “LAGER BASIC” d.o.o & “PODUZECE ZA CESTE d.oo”**  
Vlera **156 179 583.56** (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e trepikëpesëdhjetëgjashtë) lekë pa TVSH.
- 5. Operatori ekonomik “R & R GROUP”sh.p.k**  
Vlera **178 800 600** (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milion e tetëqind mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH.
- 6. Bashkimi i Përkohshëm i operatorëve ekonomike “POWER INDUSTRIES & RADIOKEJ & MUHOPLUS” ltd**  
Vlera **195 800 000** (njëqind e nëntëdhjetë e pesë milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH.
- 7. Bashkimi i Përkohshëm i operatorëve ekonomike “TEKNOXGROUP SHQIPERI” shpk & “TEKNOXGROUP SLOVENIJA” d.o.o**  
Vlera **174 771 135** (njëqind e shtatëdhjetë e katër milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e një mijë e njëqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.
- 8. Operatori ekonomik “LAGER d.oo Posusje”**  
Vlera **173 851 594.84** (njëqind e shtatëdhjetë e tre milion e tetëqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e katërpikëtetëdhjetëkatër) lekë pa TVSH.
- 9. Bashkimi i Përkohshëm i operatorëve ekonomike “T & C” shpk & “COMAR COMERCIALE” S.P.A**  
Vlera **166 011 934** (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- 1. Operatori ekonomik “EUROGJICI SECURITY” shpk**  
**Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike**



2. **Operatori ekonomik “ALMETA” GMBH**  
Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
3. **Bashkimi i Përkohshëm i operatorëve ekonomike “LAGER BASIC” d.o.o & “PODUZECE ZA CESTE d.oo”**  
Vlera **156 179 583.56** (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e trepikëpesëdhjetëgjashtë) lekë pa TVSH.
4. **Bashkimi i Përkohshëm i operatorëve ekonomike “POWER INDUSTRIES & RAD-OKEJ & MUHOPLUS” ltd**  
Vlera **195 800 000** (njëqind e nëntëdhjetë e pesë milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

V. **Bashkimi i Përkohshëm i operatorëve ekonomike “LAGER BASIC” d.o.o & “PODUZECE ZA CESTE d.oo”** është skualifikuar në këtë procedurë prokurimi për arsye se ka dorëzuar formularin e sigurimit të ofertës të lëshuar nga një Kompani Sigurimi dhe jo nga një bankë ashtu sic është kërkuar në dokumentat e tenderit, si dhe ka ndryshuar përmbajtjen e Shtojcës 4 “Formulari i sigurimit të ofertës” duke dorëzuar një “Formular” me përmbajtje të ndryshme nga ajo e përcaktuar në dokumentat e tenderit për këtë procedurë, duke shtuar rastin e mospërmbushjes së një kushti **Ofertuesi ka dorëzuar një ofertë të papërgjegjshme**. Kjo bie në kundërshtim me Kreun II “UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË”, Seksioni 1 “Hartimi i ofertës”, pika 1.1 të dokumentave të procedurës së prokurimit në të cilën parashikohet se “*Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme..*”

